



STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË – DIPLOMACI

TEZA:

“Pjesëmarrja politike e gruas në Kosovë, pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008.”

KANDIDATE:

ADEA HASI

MENTOR:

DR. AGON DEMJAHA

Shkup, Shtator, 2019.

Deklarimi mbi Originalitetin e Punimit

Me anë të kësaj deklarate vërtetoj se unë, Adea Hasi, jam autore e punimit me titull:

“Pjesëmarrja politike e gruas në Kosovë, pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008”.

Ky Punim Diplome i nivelit Master është puna ime origjinale, duke respektuar autorësinë e çdo burimi të informacioneve dhe rregullave për një punim të mirëfilltë shkencor, dhe nuk është dorëzuar, në tërësi apo pjesërisht, për ndonjë gradë në këtë apo ndonjë universitet tjetër. Sipas dijenisë time, punimi nuk përmban asnjë material të botuar ose shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit përmes praktikave të referencimit.

Falenderime

Ky punim për gradën Master ka qenë një projekt serioz për të cilin jam angazhuar vërtetë shumë dhe i kam përkushtuar një pjesë të madhe të kohës sime.

Si fillim, falenderoj Zotin për vullnetin dhe motivimin e dhënë, për të përfunduar me sukses studimet e mia Master, njëherit edhe për t'i finalizuar me këtë punim diplome.

Falenderim i veçantë shkon për mentorin tim të temës prof. Dr. Agon Demjaha, për ndihmën, përkushtimin dhe gatishmërinë e tij që kjo temë të dalë sa më profesionale dhe më e kompletuar. Falë udhëzimeve dhe këshillave të vlefshme të tij, standardet e larta të punës akademike pasqyrohen në strukturën dhe në përmbajtjen e këtij punimi. Falemnderit për zemërsisht!

Falenderim i thellë shkon për familjen time të cilët me kanë mbështetur në çdo aspekt dhe më kanë qëndruar pranë nga fillimi e deri në përfundimin e këtij udhëtimi akademik. Njëherit i falenderoj për besimin, mirëkuptimin dhe kurajon që më kanë dhënë gjithmonë. U jam mirënjohës përjetë!

Abstrakti

Ky punim masteri do ketë për fokus gratë dhe pjesëmarrjen e tyre në politikën kosovare. Edhe pse pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në politikë ende nuk është bërë pjesë e kulturës sonë politike, gratë kanë të drejtë të jenë pjesë aktive e politikës dhe aktiviteteve në të. Tradicionalisht, në kulturën kosovare politika është parë më shumë si veprimtari e burrave dhe gratë janë lënë anash. Mirëpo, sot është më se i nevojshëm involvimi femëror në politikë sepse femrat prekin fusha që janë të domosdoshme për një shoqëri të shëndoshë.

Brenda këtij punimi do analizohet korniza ligjore mbi barazinë gjinore në Kosovë, që të shihet se si parashihet roli i gruas në shoqëri dhe mbrojtja e pozitës së saj përmes ligjit. Poashtu, punimi do fokusohet në qëndrimet mbi rolin e gruas në shoqëri, dhe sa ka ndryshuar roli i gruas prej më herët e deri sot, por në anën tjetër edhe sa kanë ndryshuar qëndrimet mbi rolin që pritet gruaja të luajë në shoqëri.

Fokusi i këtij punimi do jetë gruaja në Kosovë dhe raporti i saj me politikën, duke analizuar pjesëmarrjen e saj në votime, në aktivitete politike dhe pjesëmarrjen e saj si kandidate politike. Pastaj, do hulumtohet mbi barrierat dhe pengesat në rrugën e saj drejt politikës, dhe fokus i veçantë do bie mbi kuotat gjinore, duke analizuar rolin e tyre dhe rëndësinë që kanë këto kuota për gratë që synojnë politikën.

Përmes këtij punimi synohet të vihet në pah se gratë siç ia dalin në fusha tjera jetësore njejtë mund t'ia dalin edhe në politikë, por mjedisi është ai që ua vështirëson punën. Prandaj, punimi le të shërbejë si një kontribut për avancimin e pozitës së grave në Kosovë dhe për të kuptuar se përmirësimi i pozitës së grave kërkon përkushtimin e të gjithë shoqërisë dhe mbështetjen e pakushtëzuar.

Fjalët kyqe: barazi gjinore, shoqëri, politikë, grua, Kosovë, pjesëmarrje, kornizë ligjore, rol, votim, kandidate, aktivitet, kuota gjinore, barriera, avancim.

Përmbajtja e Punimit

Falenderime	3
Abstrakti	4
Përmbajtja e Punimit	5
Lista e Shkurtesave	6
Hyrja	7
Definimi i Problemit	8
Kornizat ligjore mbi barazinë gjinore në Kosovë	11
Qëndrimet mbi rolin e gruas në familje dhe në shoqëri	20
Kapitulli I – Pjesëmarrja e grave në politikën e Kosovës	25
I.1 Pjesëmarrja e gruas në votime	26
I.2 Pjesëmarrja e gruas në aktivitete politike	27
I.3 Pjesëmarrja e gruas si kandidate politike	30
Kapitulli II – Barrierat e gruas për inkuadrim në politikë kosovare	33
II.1 Faktorët që ndikojnë në uljen e pjesëmarrjes së gruas në politikë	35
II.2 Pengesat në procesin e rekrutimit të gruas si kandidate politike	37
II.3 Sfidat e gruas gjatë një procesi zgjedhor apo fushate politike	39
Kapitulli III – Kuotat gjinore dhe pjesëmarrja e gruas në nivelin qendror dhe lokal politik	
III.1 Kuota gjinore në Kosovë dhe rëndësia e saj	42
III.2 Pjesëmarrja e gruas në Kuvend	45
III.3 Pjesëmarrja e gruas në Qeveri	48
III.4 Pjesëmarrja e gruas në Presidencë	51
III.5 Pjesëmarrja e gruas në qeverisje lokale	52
Përfundimi dhe rekomandimet	55
Bibliografia	57

Lista e Shkurtesave

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	The Convention on the Elimination of all Forms of Discrimination Against Women (Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas)
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
QKSGJ	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UNDP	United Nations Development Programme (Programi i zhvillimit të Kombeve të Bashkuara)
UNMIK	United Nations Mission in Kosovo (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)
WIIS	Women in International Security (Gratë në Sigurinë Ndërkombëtare)

Hyrje

Thuhet se gratë janë të reja në fushën e politikës por kanë përvojë në jetë, dhe shpejtë do mësojnë se përmes politikës do i parandalojnë disa vuajtje të mëhershme për gjininë e tyre. Në shoqërinë kosovare vlerësohet roli i gruas si shtyllë e shoqërisë mirëpo vërehet tendenca që ajo të mbetet e izoluar brenda disa kornizave shoqërore. Politika dhe mënyra se si ajo aktualisht zhvillohet në Kosovë, e ka shëndruar më tepër në një mjedis mashkullor dhe ka lënë shumë pak hapësirë për depërtimin e grave. Megjithatë, politika kosovare nuk shquhet si mjedis i mirëfilltë i vlerave apo meritokracisë, prandaj rruga e grave drejt pozitave politike është shumë e vështirë.

Duke qenë se më herët gruaja ka pasur vetëm rolin e shtëpiakes duke mirëmbajtur shtëpinë dhe duke u kujdesur për familjen, kjo nuk do të thotë që ajo duhet gjithmonë të qëndrojë e tillë. Me kalimin e kohës ndryshojnë edhe rolet në shoqëri. Gruaja edhe pse mbetet ende nënë dhe grua e kujdesshme, tashmë synon edhe karrierën, në këtë rast politikën. Tradicionalisht, kanë ekzistuar mendime se gruaja nuk është e aftë për të marrë vendime apo për të udhëhequr në punë, dhe këto janë ngulitur në mendjet e popullatës, duke e lënë mbrapa gjininë femërore dhe avancimin e saj. Sot, fatmirësisht në Kosovë gratë janë të vendosura për të hedhur poshtë këto mendime të pabaza dhe për të ndjekur synimet e tyre. Por, kjo nuk është e lehtë dhe rruga e tyre është me pengesa të shumta, që ua humbin vetëbesimin dhe tentojnë t'u shkatërrojnë vizionet.

Kosova ende nuk është shëndruar në vendin ku gratë mbështesin gratë, nuk është ende vendi ku familjarët mbështesin një grua në familje dhe e inkurajojnë drejt politikës, nuk është vendi ku partia i mbështet gratë dhe fuqizimin e tyre. Fatkeqësisht, Kosova ende nuk është vendi ku një grua vlerësohet për të arriturat e saj dhe mbështetet për punën që bën, por prapë diferencohet për faktin se është femër dhe do jetë gjithmonë një mashkull ai që do kryejë punën e saj më mirë se ajo.

Pjesëmarrja politike e gruas në Kosovë lë shumë për të dëshiruar. Ende vazhdojnë votimet familjare, imponimet në votime ose mosvlerësimi i votës së gruas duke i thënë të mos votojë fare, mosdëgjimi i opinionit të gruas mbi një kandidat apo subjekt politik, pjesëmarrja e ulët e gruas në tubime ose aktivitete të ndryshme politike, propozimet e pakta të gruas si kandidate, vazhdojnë dekurajimet dhe mosmbështetja, vazhdon diskriminimi dhe shkelja e meritave dhe të drejtave të gruas. Gratë sot edhe po i kushtojnë rëndësi arsimit dhe kanë bagazhe akademike, mirëpo duket se janë të pamjaftueshme për të arritur diçka në politikë për faktin e vetëm se nuk janë burra.

Le të kuptohet fakti se nuk ka kufi ajo çfarë gratë mund të arrijnë në politikë dhe në fusha tjera, edhe pse kanë shumë më tepër përgjegjësi sesa burrat ia dalin që t'i kryejnë të gjitha. Kështu që shoqëria në Kosovë duhet të fillojë të bëhet më mendjehapur dhe të mos quhet shoqëri demokratike vetëm në letër por ta dëshmojë edhe në praktikë. Duhet të rritet mbështetja ndaj grave, të përkushtohet gjithë shoqëria për avancimin e gruas, fillimisht duke i besuar dhe duke i dhënë kurajo se do ia dalë mbanë asaj që synon, sepse do ia dalë vërtetë. Kur gratë përfshihen në politikë përfiton e gjithë shoqëria.

Definimi i Problemit

1. Lënda e hulumtimit

Gjinia/seksi është një konstrukt shoqëror që ndikon në ndarjen e punës midis grave dhe burrave, pjesëmarrjen në edukim, llojet e punës që do bëjnë dhe punësimin që njerëzit kanë, dhe qasjen në të ardhura dhe pasuritë e familjes.

Me anë të një numri të madh të dokumenteve garantohet barazia gjinore dhe garantohet mundësia e depërtimit të gruas në politikë, si dhe nxitja e pjesëmarrjes së saj në këtë sferë. Nëse i referohemi shtetit të Kosovës, mund të thuhet se ai ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm konventash dhe kartash detyruese dhe obliguese për përfshirjen e gruas në politikë, ndërsa si garanti më i madh i të drejtave të gruas është Kushtetuta.

Mirëpo, nëse i referohemi realitetit, shihet se gratë nuk gëzojnë të njëjtat të drejta si burrat por as të njëjtin autoritet në shoqëri. Ato nuk inkurajohen sa duhet për një pjesëmarrje në politikë apo në sferat tjera të jetës, dhe arritja e qëllimeve të tyre shpesh bëhet e vështirë nga mjedisi mashkullor rrethues. Pjesëmarrja politike e gruas në Kosovë nuk është e kënaqshme, madje as integrimi i saj ekonomik, arsimimi adekuat, përfaqësimi në media apo kulturë. Për shembull, momentalisht nga gjitha ministratë në Kosovë, vetëm dy udhëhiqen nga femra ministre ndërsa pjesa tjetër janë nën udhëheqjen e meshkujve. Nga pesë zëvendës kryeministra, gjithë janë meshkuj dhe asnjë femër nuk e ushtron këtë post. Nga 79 zëvendësministra, vetëm 7 janë femra ndërsa 72 janë meshkuj. Nga 38 komuna në Kosovë, gjithë postet e kryetarëve ushtrohen nga meshkujt. Ndërsa më pak se 20 për qind e drejtorive komunale në Kosovë udhëhiqen nga femrat. Në shumë shtete të Ballkanit, si më zgjerimin ashtu edhe me reduktimin e punonjësve të administratës, gratë kanë qenë ato që kanë pësuar, pasi shumica mashkullore ka dominuar, si në punësim në rast zgjerimi, ashtu edhe në qendrim në rast reduktimi.

Prandaj, shtetet kanë përvetësuar sistemin e kuotave për të rritur pjesëmarrjen e gruas në politikë, që mund të konsiderohet si një ndër progreset më të mëdha të këtyre shteteve. Me aplikimin e kutoave pjesëmarrja e gruas në politikë është rritur, por qasja në vendimarrje është prapë e izoluar. Sistemi i kuotave dhe involvimi i gruas në përgjithësi nuk duhet parë si një hap drejt Bashkimit Evropian por duhet parë si respektim i të drejtave të njeriut dhe mundësi e barabartë për të gjithë.

2. Qëllimet e hulumtimit

Sipas ligjit për Barazi Gjinore në Kosovë thuhet se “përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur

sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”.¹

Përmes këtij hulumtimi dua të vërtetoj se gruaja është e diskriminuar ende, përkundër lehtësimeve që i bëhen për tu inkuadruar në politikë apo në fusha të tjera të jetës.

Qëllimi i hulumtimit është të vlerësohet pjesëmarrja e grave në politikë në Kosovë, si dhe në vendimmarrje në nivelin qendror (Qeveri, Kuvend dhe Presidencë) dhe në nivelin lokal (komuna) në Kosovë.

Pastaj, me anë të hulumtimit do të paraqitet ndikimi i kuotave në përfaqësimin e grave, adaptimin e tyre në sistemin politik kosovar dhe njëkohësisht progresin e bërë në këtë aspekt.

Njëkohësisht, hulumtimi ka për qëllim të identifikojë pengesat për pjesëmarrjen e grave në politikë. Ndër këto pengesa, do të analizohen një sërë të tillash si barrierat kulturore të trashëguara, sociale, ekonomike, ligjore, por edhe vullneti politik.

Poashtu, hulumtimi ka për qëllim të analizojë se a janë kuotat mënyrë demokratike që përmirësojnë disbalancin në politikë, apo ndoshta janë edhe një formë jomeritokratike, pasi me sistemin e kuotave nuk promovohen gjithmonë personat me kapacitet dhe përgatitje profesionale por persona për të mbushur vendet e ndara.

Duke marrë parasysh se Kosova synon tash e sa vite antarësimin në Bashkim Evropian, çështja e përfaqësimit të gruas në vendimmarrje mbetet ende një sfidë në të cilën duhet punuar fort.

3. Hipotezat

1. Gruaja në Kosovë është e diskriminuar në aspektin shoqëror, politik dhe ekonomik.
2. Kuotat në masë të caktuar e përmirësojnë pjesëmarrjen politike të gruas në ato institucione ku aplikohen.

4. Metodologjia e hulumtimit

Brenda këtij hulumtimi, metodologjitë e përdorura do jenë:

-Metodologjia Empirike – për shkakun se do bazohem në literaturat e ndryshme botërore, ligje, direktiva, akte nënligjore, dokumente, aktvendime, rregullore dhe janë kontrolluar arkiva në internet, si burime për hulumtimin.

-Metodologjia Analitike- për të evidentuar sistemin e kuotave dhe për të analizuar implementimin e saj, për të parë efektet e saj në nivelin qendror dhe lokal në Kosovë dhe poashtu do analizoj barrierat që hasin gratë për t'u përfshirë në proceset politike në Kosovë. Synohet të arrihet një analizë sistematike e procesit të kuotave, duke u munduar të arrihen njohuri sa më të gjëra mbi ndikimin e gruas si aktor në procesin e politikë-bërjes.

¹ Ligji për Barazi Gjinore, Republika e Kosovës, (Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 6, pika 8)

5. Rëndësia e punimit

Fillimisht, mund të them se punimi bart në vete një rëndësi të veçantë sepse prek një temë shumë të rëndësishme sociale, pra pjesëmarrjen e gruas si një aktor që mund të japë shumë kontribut në një fushë shumë delikate dhe komplekse siç është politika.

Mirëpo, barrierat që kanë gratë dhe me të cilat ato ballafaqohen për të depërtuar sadopak në jetën politikë të shtetit janë të panumërta, prandaj përmes këtij punimi synohet që të thellohen më tepër hulumtimet në këtë drejtim.

Punimi ka rëndësi sepse do analizojë dhe sqarojë sistemin e kuotave gjinore në shtetin e Kosovës, efektin, anët pozitive dhe negative të kuotimit dhe sa po punohet që kuotimi gjinor të jetë i bazuar në meritokraci.

Punimi do bazohet në nivelin qendror dhe lokal, pra do analizohen kuotat gjinore dhe impakti i tyre në nivelin ekzekutiv, legjislativ dhe poashtu edhe në gjyqësor. Ndërsa, do preket edhe niveli lokal përkatësisht niveli komunal, dhe do analizohet pjesëmarrja e grave në asamblетë përkatëse komunale.

Punimi është i rëndësishëm pasi vë në pah se pjesëmarrja e gruas në politikë është jetike për shtetin, pasi gratë janë ato që ekuilibrojnë dhe stabilizojnë politikat tepër ambicioze dhe të vrullshme të gjinisë mashkullore. Gratë kanë aftësitë e tyre “të buta” ku punët synojnë t’i kryejnë me shumë përgjegjësi, mirësjellje, fleksibilitet në detyrë dhe arsyeshmëri të lartë, dhe janë më të qëndrueshme, më të ndjeshme dhe më komunikuese.

Përmes punimit dua të kontriboj në faktin se si në vendet e tjera ashtu edhe në Kosovë, gratë mund ta bëjnë balancimin e jetës private me atë publike, ose të mbajnë edhe familjen edhe punën, por duhet të luftohet mentaliteti aktual dhe tu reduktohen grave barrierat e vendosura kundrejt një karriere të synuar.

Kornizat ligjore mbi barazinë gjinore në Kosovë

Termi “barazi gjinore” sipas fjalorit të Kembrixhit nënkupton aktin e trajtimit të barabartë të burrave dhe grave edhe pse burrat dhe gratë nuk janë të njëjtë.² Ndërsa sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara, barazia mes burrave dhe grave u referohet të drejtave, përgjegjësisë dhe mundësive të barabarta mes grave dhe burrave, djemve dhe vajzave.³

Barazia e të drejtave për gratë është një parim bazë i Kombeve të Bashkuara. Preambula e Kartës së Kombeve të Bashkuara përcakton si një nga qëllimet kryesore të Organizatës riafirmimin e "besimit në të drejtat themelore të njeriut, në dinjitetin dhe vlerën e njeriut, në të drejtat e barabarta të burrave dhe grave".⁴ Neni 1 shpall se një prej qëllimeve të Kombeve të Bashkuara është arritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në promovimin dhe inkurajimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore për të gjithë, pa dallim ndër të tjera, gjinisë.⁵ Sipas kushteve të Kartës, instrumenti i parë ndërkombëtar që i referohet në mënyrë specifike të drejtave të njeriut dhe të drejtave të barabarta të burrave dhe grave, të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara janë të detyruar ligjërisht të përpiqen drejt realizimit të plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kështu, statusi i të drejtave të njeriut, duke përfshirë qëllimin e barazisë midis grave dhe burrave, është një çështje e etikës e shëndruar në një detyrim kontraktual tek të gjitha qeveritë dhe OKB-ja.⁶

Sipas “Konventes së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër gruas” (CEDAW) barazia gjinore nënkupton stadin e arrirë kur gratë dhe burrat i gëzojnë të njëjtat mundësi dhe të drejta në gjitha sektorët e shoqërisë, duke përfshirë pjesëmarrjen ekonomike dhe vendim-marrjen, dhe atëherë kur sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të burrave dhe grave janë njësoj të vlerësuara dhe të perceptuara.⁷ Kjo konventë është shumë e rëndësishme pasi që ndërton agjenda kombëtare për të luftuar diskriminimin ndaj grave dhe për të nxitur barazinë gjinore në sfera të ndryshme jetësore. Ishte adaptuar më 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.⁸ Konventa përbëhet nga 30 nene dhe ka për qëllim të inkorporojë parimin e barazisë së burrave dhe grave në sistemet ligjore të shteteve, të shfuqizojë të gjitha ligjet diskriminuese dhe të miratojë ato të përshtatshmet që ndalojnë diskriminimin ndaj grave; të krijojë tribunale dhe institucione të tjera publike për të siguruar mbrojtjen efektive të

² Cambridge Business English Dictionary, Cambridge University Press, 2019.

<https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/gender-equality>

³ “Concepts and definitions”, United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women.

<https://www.un.org/womenwatch/osagi/conceptsanddefinitions.htm>

⁴ “Preamble”, United Nations Charter. <https://www.un.org/en/sections/un-charter/preamble/>

⁵ “Chapter I”, United Nations Charter. <https://www.un.org/en/sections/un-charter/chapter-i/index.html>

⁶ “Short History of CEDAW Convention”, United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women. <https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/history.htm>

⁷ “What is Gender Equality?”, Gender equality in Ireland. <http://www.genderequality.ie/en/GE/Pages/WhatisGE>

⁸ “UN Convention on the Elimination of all forms of Discrimination against Women (CEDAW)”, Gender Quality in Ireland. <http://www.genderequality.ie/en/GE/Pages/CEDAW>

grave kundër diskriminimit dhe për të siguruar eliminimin e të gjitha akteve të diskriminimit ndaj grave nga personat, organizatat ose ndërmarrjet.⁹

Sipas Këshillit të Evropës “barazia gjinore” nënkupton vizibilitet të barabartë, fuqizim dhe pjesëmarrje të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës publike dhe private. Gjithashtu do të thotë një qasje të barabartë dhe shpërndarje të burimeve midis grave dhe burrave duke i vlerësuar të dyja palët në mënyrë të barabartë. Realizimi i de facto barazisë midis grave dhe burrave ka qenë synim në agjendën e punës së Këshillit të Evropës për dekada të tëra.¹⁰

Në Republikën e Kosovës, pjesa e barazisë gjinore dhe ushtrimit të të drejtave të grave në sfera të ndryshme jetësore, rregullohet me anë të ligjeve përkatëse, përkatësisht me anë të aktit më të lartë juridik në Kosovë- Kushtetutës. Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku specifikohen kompetencat e Kuvendit, theksohet se një ndër kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës është të miratojë ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme. Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjin 05/L-020 për barazi gjinore që është shpallur me dekreten nr. DL-016-2015, me datë 15.06.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga. ndërsa është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me numër 16, në datën 26 Qershor 2015, Prishtinë. Ligji për barazi gjinorë në Republikën e Kosovës ka gjithsej gjashtë kapituj dhe 26 nene.¹¹

I - Dispozitat e përgjithshme ku hyjnë qëllimi, fushëveprimi, përkufizimet, ndalimi i diskriminimit gjinor, masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore dhe masat e veçanta.¹²

II - Mekanizmat institucionalë për barazi gjinore ku hyjnë agjencia për barazi gjinore, funksionet dhe përgjegjësitë, organizimi i agjencisë, financimi, Programi i Kosovës për barazi gjinore, zyrtarët/et përkatës për barazi gjinore në ministri dhe komuna, avokati i popullit dhe partitë politike.¹³

III - Mbrojtja dhe trajtimi i barabartë në bazë të përkatësisë gjinore në marrëdhëniet e punës që përbëhet nga neni për ndalimin e diskriminimit gjinor në marrëdhëniet e punës, ndalimi i diskriminimit gjinor në skemat e sigurimit shoqëror në punë, detyrimet e punëdhënësit në marrëdhëniet e punës, vlerësimi i punës së papaguar dhe neni për ndalimin e diskriminimit gjinor në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime.¹⁴

⁹ “Overview of the Convention”, United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women.

<https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/index.html>

¹⁰ “Equality between women and men”, Council of Europe.

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168064f51b>

¹¹ “Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi gjinore”, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 16, 26 qershor 2015, Prishtinë.

¹² “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli I, “Dispozitat e Përgjithshme”, Prishtinë, 2015, fq.1.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10923>

¹³ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli II, “Mekanizmat Institucionalë për Barazi Gjinore”, Prishtinë, 2015, fq.6.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10923>

¹⁴ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli III, “Mbrojtja dhe trajtimi i barabartë në bazë të përkatësisë gjinore në marrëdhëniet e punës”, Prishtinë, 2015, fq.9.

IV - Trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi në baza gjinore në fushën e arsimit ku hyjnë ndalimi i diskriminimit gjinor dhe trajtimit të pabarabartë, edukimi për barazinë gjinore dhe mbrojtja juridike e të drejtës së trajtimit të barabartë të femrave dhe meshkujve.¹⁵

V - Sanksionet ku marrin pjesë nenet për dispozita kundërvajtëse.¹⁶

VI - Dispozitat përfundimtare ku hyjnë nxjerrja e akteve nënligjore, shfuqizimet dhe hyrja në fuqi.¹⁷

Ligji për Barazi Gjinore në Republikën e Kosovës ka disa qëllime dhe këto janë: garantimi, mbrojtja dhe promovimi i barazisë mes gjinive, pasi shihet si një vlerë e rëndësishme për themelet e një shoqërie demokratike. Poashtu ky ligj përcakton disa masa, që mund të jenë të përgjithshme ose të veçanta me qëllim mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të barabarta si për femrat ashtu edhe për meshkujt, dhe përcaktimin e institucioneve përgjegjëse bashke me kompetencat përkatëse. Ky ligj përputhet me Konventa dhe Direktiva të ndryshme dhe si të tilla mund të përmenden: Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Femrës (CEDAW); Direktiva për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtim të barabartë të meshkujve dhe femrave në çështjet e punësimit dhe profesionit (Direktiva 2006/54/EC); Direktiva në zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë të meshkujve dhe femrave në çështjet e sigurimit shoqëror (Direktiva e Këshillit, datë 19 dhjetorit 1978 (79/7/EEC); Direktiva për krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe profesion (Direktiva 2000/78/EC); Direktiva mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis meshkujve dhe femrave të angazhuar në një aktivitet në një kapacitet të vetë-punësuar dhe Direktiva për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis meshkujve dhe femrave në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime (Direktiva 2004/113/EC).¹⁸

Ky ligj bart në vete një rëndësi tepër të madhe pasi mundëson dhe garanton trajtimin e barabartë të personave pa qenë të diferencuar apo të diskriminuar prej identitetit gjinor, dhe mundëson barazi në sferat e ndryshme jetësore, duke nisur nga punësimi, arsimimi dhe edukimi, ekonomia, shëndetësia, përfitimet sociale, sporti, kultura dhe fusha tjera ku personat e gjejnë veten të përfshirë.¹⁹ Përmes përkufizimit ligjor, barazia gjinore është “ushtrimi i plotë dhe i barabartë i të drejtave të njeriut, si nga gjinia femërore ashtu dhe nga ajo mashkullore, është mosprania e diskriminimit në bazë gjinore në mundësitë, ndarjen e burimeve apo përfitimeve si dhe qasjen në shërbime.”²⁰. Poashtu në të njëjtin nen përkufizohet se si femër ashtu edhe mashkull

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10923>

¹⁵ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli IV, “Trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi në baza gjinore në fushën e arsimit”, Prishtinë, 2015, fq.13. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10923>

¹⁶ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli V, Sanksionet, Prishtinë, 2015, fq.14.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10923>

¹⁷ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli VI, “Dispozitat Përfundimtare”, Prishtinë, 2015, fq.15.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10923>

¹⁸ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli I, “Dispozitat e Përgjithshme”, Neni 1/ Qëllimi, Prishtinë, 2015, fq.1.

¹⁹ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli I, “Dispozitat e Përgjithshme”, Neni 2/ Fushëveprimi, Prishtinë, 2015, fq.1.

²⁰ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli I, “Dispozitat e Përgjithshme”, Neni 3 / Përkufizimet, Prishtinë, 2015, fq.2.

nënkuptohet çdo person që e konsideron veten të tillë pavarësisht moshës dhe statusit martesor. Ndërsa trajtimi i barabartë nënkupton trajtimin pa kurrfarë diskriminimi të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të gjinisë.²¹

Në ligjin për barazi gjinore të Republikës së Kosovës sqarohet se diskriminimi i drejtëpërdrejtë gjinor ndodhë atëherë kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme seq trajtohen të tjerët. Kurse me diskriminim të tërthortë nënkuptohet kur një dispozitë, kriter apo praktikë e paanshme në dukje e vë, e ka vënë apo do ta vë personin e gjinisë tjetër në pozitë të pabarabartë, përveç në rastet kur dispozita, praktika apo kriteri i tillë mund të arsyetohet në pikëpamje objektive me një qëllim legjitim, dhe mjetet për arritjen e qëllimit janë të përshtatshme dhe domosdoshme.²²

Sipas nenit 4, ndalohet diskriminimi gjinor, si i drejtëpërdrejtë ashtu dhe ai i tërthortë, dhe nuk lejohet trajtimi më pak i favorshëm i femrave për shkak të shtatëzanisë ose amësisë, gjendjes martesore, racës, kombësisë, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, statusit social, besimit fetar, moshës apo me ndonjë bazë tjetër të përcaktuar me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare në fuqi. Poashtu neni 4 ndalon dhunën me baza gjinore sepse e konsideron si formë diskriminimi që pengon aftësinë e femrave dhe meshkujve që t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre në baza të barabarta, dhe ndalon gjithashtu edhe ngacmimin seksual.²³ Neni 3 e përkufizon ngacmimin seksual si formë të padëshiruar të sjelljes verbale, joverbale apo fizike me natyrë seksuale, me qëllim apo pasojë prekjen apo shkeljen e dinjitetit të një personi, dhe për të krijuar një mjedis poshtërues, fytes, degradues, armiqësor dhe frikësues.²⁴

Neni 5 shpreh masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore, masa për të cilat duhet institucionet shtetërore të nivelit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor, dhe institucione tjera publike të japin përgjegjësi lidhur me zbatimin e masave legislative dhe masave tjera ku përfshihen: analiza e statusit të femrave dhe meshkujve në organizatat dhe fushat përkatëse; miratimi i strategjive dhe planeve të veprimit për promovimin dhe zhvillimin e barazisë gjinore, përfshirja e integritet gjinor në politika, dokumente të ndryshme dhe në legjislacion, sigurimi i proceseve të përzgjedhjes, punësimit dhe caktimit në punë, duke përfshirë edhe pozicione drejtuese, në përputhje me kërkesën për përfaqësim të barabartë të femrave dhe meshkujve; përfshirja e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat; sigurimin e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve në të gjitha konferencat, mbledhjet, seminarët dhe trajnimet jashtë dhe brenda vendit; caktimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare për programe, projekte dhe iniciativa për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin

²¹ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli I, “Dispozitat e Përgjithshme”, Neni 3/ Përkufizimet, Prishtinë, 2015, fq 2.

²² “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli I, “Dispozitat e Përgjithshme”, Neni 3/ Përkufizimet, Prishtinë, 2015, fq 2.

²³ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli I, “Dispozitat e Përgjithshme”, Neni 4/ Ndalimi i diskriminimit gjinor, Prishtinë, 2015, fq.4.

²⁴ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli I, “Dispozitat e Përgjithshme”, Neni 3/ Përkufizimet, Prishtinë, 2015, fq 2.

e femrave; të mirret parasysh barazia gjinore në rastin e emërtimit të institucioneve, shkollave apo rrugëve.²⁵

Ndërsa neni 6 i ligjit për barazi gjinore mbart në vete një rëndësi të veçantë sepse “përfshin në vete masat e veçanta të përkohshme që synojnë përsheptimin e realizimit të barazisë midis femrave dhe meshkujve sidomos në ato fusha ku ekzistojnë ende pabarazi” dhe këto fusha nuk janë të pakta në Kosovë. Masat e veçanta përfshijnë: kuotën si një mënyrë për të arritur përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve por edhe si një mënyrë për të avancuar pozitën e femrës; programe të ndryshme për të ndihmuar dhe mbështetur rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në jetën publike dhe në vendimmarrje; fuqizim ekonomik dhe përfaqësim të rritur në punësim, arsim, kulturë, sport, shëndetësi; trajtim preferencial, rekrutimin, punësimin dhe ngritjen në detyrë, dhe masa të tjera në secilën fushë ku ka pabarazi; organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji.²⁶

Poashtu, është me rëndësi të dihet se në të gjitha organet legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe në institucionet tjera publike, përfaqësimi i barabartë arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre vendimmarrëse dhe drejtuese përkatëse. Pra, barazia e plotë ose përfaqësimi i barabartë do ishte kur të dyja gjinitë do qëndronin në përqindje të njejtë të pjesëmarrjes.²⁷

Sa i përket kapitullit të dytë të ligjit për barazi gjinore, lidhet me mekanizmat institucionalë për barazi gjinore. Në nenin 7 tregohet ekzistenca e agjencisë për barazi gjinore, si agjenci ekzekutive që vepron në kuadër të zyrës së kryeministrit.²⁸ Agjencia ka këto përgjegjësi: fillimisht e bën zbatimin e dispozitave dhe akteve nënligjore që nxirren në pajtim me këtë ligj, dhe poashtu mundëson promovimin, koordinimin dhe mbështetjen e tyre, pastaj propozon ndryshimet ose plotësimet e ligjeve ose të akteve nënligjore dhe sipas procedurave ligjore në fuqi bën miratimin e masave për zbatimin e këtij ligji; bën hartimin por edhe identifikimin e politikave që promovojnë barazinë gjinore dhe monitoron shkallën e zbatimit të tyre; marrin pjesë në hartimin e ligjeve, udhëzimeve, programeve, strategjive për barazi gjinore dhe integrim gjinor; ka për qëllim ngritjen e vetëdijes mbi barazinë gjinore, analizon gjendjen e barazisë gjinore në Kosovë duke u bazuar në raporte, studime, hulumtime, opinione, rekomandime dhe rezultatet përfundimtare i publikojnë; merr masa adekuate për promovimin e trajtimit të

²⁵ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli I, “Dispozitat e Përgjithshme”, Neni 5 / Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore, Prishtinë, 2015, fq.4.

²⁶ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli I, “Dispozitat e Përgjithshme”, Neni 6/ Masat e veçanta, Prishtinë, 2015, fq.5.

²⁷ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli I, “Dispozitat e Përgjithshme”, Neni 6/ Masat e veçanta, Prishtinë, 2015, fq.5.

²⁸ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli II, “Mekanizmat Institucionalë për Barazi Gjinore”, Neni 7/ Agjencia për Barazi Gjinore, Prishtinë, 2015, fq.6.

barabartë gjinor në bashkëpunim me partnerët social, përmes zhvillimit të dialogut social për të punësuarit dhe punëdhënësit; organizon trajnime për përfshirjen e integritit gjinor; hap pas hapi udhëheq dhe monitoron zbatimin e Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Femrës dhe njëkohësisht kontribon në zbatimin e saj.²⁹

Sipas nenit 9, ku përshkruhet organizimi i agjencisë, përmendet se agjencia udhëhiqet nga Kryeshefi/ja Ekzekutiv/e i/e cili/a mban përgjegjësi për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e punëve të Agjencisë. Emërimet, shkarkimet dhe funksionet tjera rregullohen me dispozitat përkatëse ligjore, ndërsa organizimi, strukturimi dhe funksionimi i Agjencisë rregullohen me akt nënligjor të cilin e propozon Agjencia dhe e miraton Qeveria.³⁰

Sa i përket financimit, në nenin 10 shprehet qartë se kjo agjenci financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës mirëpo pranohen edhe donacione. Donatorë të ndryshëm vendorë ose ndërkombëtarë lejohet të japin kontribut mirëpo me kushtin që mos të kenë ndikim në pavarësinë financiare të agjencisë ose të mos bien ndesh me ligjet e Republikës. Poashtu, çdo donacion i marrë duhet të bëhet publik nga ana e agjencisë.³¹ Agjencia për barazi gjinore raporton çdo vit te qeveria ndërsa qeveria shqyrton dhe miraton Programin e Kosovës për Barazi Gjinore dhe raporton çdo vit në Kuvend për zbatimin e tij dhe këto raporte bëhen publike.³²

Neni 12 sqaron zyrtarët/et përkatës për barazi gjinore në ministri dhe komuna, ku thuhet se çdo ministri dhe komunë duhet të punësojë zyrtarë me kapacitete profesionale, pra që janë të kualifikuar për punën dhe janë të përgatitur, dhe të ndahen mjaftueshëm burime nga buxheti që të kordinohen dispozitat ligjore. Zyrtarët përkatës për barazi gjinore kanë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ku mund të theksohen koordinimi dhe zbatimi i ligjit poashtu edhe Programit për Barazi Gjinore; përfshirjen e Integritit Gjinor dhe ndarjen e buxhetit për politikat gjinore; bashkëpunimin me Agjencinë për Barazi Gjinore; përgatitja e raporteve një vjeçare për zbatimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, si dhe raportet tjera që i dorëzohen Agjencisë.³³ Neni 13 i kapitullit të dytë ka në qendër avokatin e popullit si një institucion i barazisë që trajton rastet që mirren me diskriminim ligjor³⁴. Ndërsa neni 14 lidhet me partitë politike të cilat duhet të

²⁹ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli II, “Mekanizmat Institucionalë për Barazi Gjinore”, Neni 8/ Funksionet dhe përgjegjësitë, Prishtinë, 2015, fq.6,7.

³⁰ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli II, “Mekanizmat Institucionalë për Barazi Gjinore”, Neni 9/ Organizimi i Agjencisë, Prishtinë, 2015, fq.7.

³¹ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli II, “Mekanizmat Institucionalë për Barazi Gjinore”, Neni 10/ Financimi, Prishtinë, 2015, fq.7,8.

³² “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli II, “Mekanizmat Institucionalë për Barazi Gjinore”, Neni 11/ Programi i Kosovës për barazi gjinore, Prishtinë, 2015, fq.8.

³³ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli II, “Mekanizmat Institucionalë për Barazi Gjinore”, Neni 12/ Zyrtarët/et përkatës për barazi gjinore në ministri dhe komuna, Prishtinë, 2015, fq.8.

³⁴ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli II, “Mekanizmat Institucionalë për Barazi Gjinore”, Neni 13/ Avokati i Popullit, Prishtinë, 2015, fq.8

zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave në organet e partisë politike.³⁵

Sa i përket kapitullit të tretë, është kapitull që mirret me mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë në bazë të përkatësisë gjinore në vendin e punës. Neni 15 me rradhë njëherit edhe neni i parë i këtij kapitulli, shpreh ndalimin e diskriminimit gjinor në vendet e punës. Ky nen ndalon çdo lloj diskriminimi në vendin e punës, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në bazë të gjinisë, përkatësisë, etnisë, statusit familjar, shtatëzani, lindjes, kujdestarisë etj. Brenda nenit thuhet se si në sektorin publik ashtu edhe privat, duhet të krijohen kushtet e favorshme për qasje në punësim në gjitha shkallët e hierarkisë dhe avancimin e tyre, qasjes në të gjitha llojet dhe nivelet e drejtimit profesional, trajnimit profesional dhe të avancuar dhe rikualifikimet përfshirë përvojën e punës praktike; punësim dhe kushte pune duke përfshirë edhe shkarkimin dhe pagën, të lejohet dhe inkurajohet inkudrimi në organizata të ndryshme.³⁶

Neni 16 lidhet me ndalimin e diskriminimit gjinor në skemat e sigurimit shoqëror në punë. Neni saktëson se: “Ndalohe diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të gjinisë në të gjitha skemat e sigurimit shoqëror në punë, në veçanti sa i përket: fushës së skemave të tilla dhe kushtet e qasjes në to; detyrimit për të kontribuar dhe llogaritjet e kontributeve; llogaritjes së përfitimeve, përfshirë përfitimet suplementare në lidhje me bashkëshortin/en apo vartësve, si dhe kushtet që rregullojnë kohëzgjatjen dhe gëzimin e të drejtës për përfitime.”³⁷ Poashtu në këtë kapitull sqarohet edhe pjesa e detyrimeve të punëdhënësit në marrëdhëniet e punës. Punëdhënësi/ja ka këto obligime: duhet që kur të hapë vend të lirë pune të shmangë çdo lloj elementi diskriminues në bazë të gjinisë; duhet që në ambientin e punës të mos ketë frymë diskriminuese dhe të promovohet barazia gjinore; mundësitë e aplikimit të jenë të barabarta si për femrat ashtu edhe për meshkujt; nëse në një kategori të caktuar pune nuk ka barazi gjinore, nuk paraqet diskriminim nëse inkurajohet gjinia më pak e përfaqësuar për aplikim; nuk duhet disfavorizuar një punëkërkuar duke vendosur kritere që ndoshta duken neutrale por në fakt tërthorazi diskriminojnë; duhet zbatuar kritere të barabarta në vlerësimin e cilësisë së punës; duhet që si femrat ashtu edhe meshkujt të kenë mundësi të barabarta në qasje në trajnime apo në arsim profesional; dhe përfundimisht duhet që dallimet gjinore të mos ekzistojnë në asnjërën prej hierarkive profesionale; për punën e njëjtë edhe paga duhet të jetë e njëjtë; punëdhënësi është i obliguar që të krijojë një mjedis ku asnjëra prej gjinive nuk do jetë subjekt i trajtimit të padëshirueshëm të natyrës seksuale nga punëdhënësi apo kolegët, duke përfshirë trajtimin e padëshiruar fizik, verbal ose joverbal apo sjelljet seksuale që krijojnë një mjedis degradues, poshtërues, ofendues dhe cenojnë dinjitetin e femrave ose meshkujve në punë; punëdhënësi duhet

³⁵ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli II, “Mekanizmat Institucionalë për Barazi Gjinore”, Neni 14/ Partitë politike, Prishtinë, 2015, fq.9.

³⁶ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli III, “Mbrojtja dhe Trajtimi i barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore, në marrëdhëniet e punës”, Neni 15/ Ndalimi i diskriminimit gjinor në marrëdhëniet e punës, Prishtinë, 2015, fq.9.

³⁷ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli III, “Mbrojtja dhe Trajtimi i barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore, në marrëdhëniet e punës”, Neni 16/ Ndalimi i diskriminimit gjinor në skemat e sigurimit shoqëror në punë, Prishtinë, 2015, fq.9,10.

t'u mundësojë punëtorëve të përshtasin obligimet profesionale dhe ato familjare; t'u mundësojë përshtatjen e orarit dhe t'u sigurojë kthimin në vendin e njëjtë të punës pas pushimit të lindjes, pushimit prindëror, pushimit të abortit, pushimit mjekësor apo pushimit për ndonjë arsye urgjente.³⁸

Neni 18 flet për vlerësimin e punës së papaguar. Si për femrat ashtu edhe për meshkujt, punë e papaguar konsiderohet vetëm kontributi që japin për familjen e tyre, për shembull kur kujdesen për mirëqenien e familjes, për rritjen e fëmijëve, ose kur bëjnë punë në bujqësi ose ekonomi familjare.³⁹ Kurse ndalimi i diskriminimit gjinor në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime sqarohet në nenin 19. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat të cilët ofrojnë mallra dhe shërbime, të cilët janë në dispozicion për publikun (pavarësisht a janë të sektorit publik apo privat).⁴⁰

Kapitulli i katërt i ligjit për barazi gjinore ka të bëjë me trajtimin e barabartë dhe mbrojtjen nga diskriminimi në baza gjinore në fushën e arsimit. Kjo përfshin fushat e arsimit në gjitha nivelet, duke përfshirë qasjen, procedurën e pranimit, vlerësimet, rezultatet, përfitimet dhe bursat, marrjen e diplomave dhe titujve të ndryshëm shkencorë, qasjen në trajnime profesionale etj.⁴¹

Diskriminim, sipas përkufizimit ligjor përbëjnë këto veprime dhe janë të ndaluara: “çdo kufizim apo pengesë me bazë gjinore në krijimin e mundësive të nevojshme, për t'u shkolluar në institucione publike e private, të cilat ofrojnë shkollim apo kualifikime tjera dhe shërbime trajnimi; ofrimin e mundësive të ndryshme për meshkujt dhe femrat në zgjedhjen e fushës së veçantë të studimit, trajnim apo diplomim, dhe në lidhje me kohëzgjatjen e klasave, përveçse kjo përligjet nga një qëllim i ligjshëm dhe mjetet për arritjen e atij qëllimi janë ato që duhen dhe të nevojshme.”⁴²

Neni i radhës (neni 21) lidhet me edukimin për barazinë gjinore, ku thuhet se nëpër shkolla dhe institucione arsimore të çdo lloji baza e planit mësimor dhe kurrikulumeve duhet të jetë barazia gjinore. Poashtu tekstet dhe materialet duhet të përfshijnë perspektivën gjinore dhe eliminimin e stereotipeve negative, paragjykimëve, praktikave zakonore dhe praktikave tjera, që janë në kundërshtim me parimin e barazisë gjinore. Përmenden edhe profesionet tipike të femrave dhe

³⁸ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli III, “Mbrojtja dhe Trajtimi i barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore, në marrëdhëniet e punës”, Neni 17/ Detyrimet e punëdhënësit në marrëdhëniet e punës, Prishtinë, 2015, fq.11,12.

³⁹ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli III, “Mbrojtja dhe Trajtimi i barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore, në marrëdhëniet e punës”, Neni 18/ Vlerësimi i punës së papaguar, Prishtinë, 2015, fq.12.

⁴⁰ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli III, “Mbrojtja dhe Trajtimi i barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore, në marrëdhëniet e punës”, Neni 19/ Ndalimi i diskriminimit gjinor në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime, Prishtinë, 2015, fq.13.

⁴¹ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli IV, “Trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi në baza gjinore në fushën e arsimit”, Neni 20/ Ndalimi i diskriminimit gjinor dhe trajtimit të pabarabartë, Prishtinë, 2015, fq.13.

⁴² “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli IV, “Trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi në baza gjinore në fushën e arsimit”, Neni 20/ Ndalimi i diskriminimit gjinor dhe trajtimit të pabarabartë, Prishtinë, 2015, fq.13.

meshkujve dhe thuhet se duhet të punohet në thyerjen e këtyre barrierave dhe inkuadrimin e të dyja gjinive në gjitha llojet e profesioneve.⁴³

Neni 22 ka të bëjë me mbrojtjen juridike të së drejtës së trajtimit të barabartë të femrave dhe meshkujve. Citohet se: “Personat të cilët konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, mund të iniciojnë procedura dhe paraqesin prova para organit administrativ apo Gjykatës kompetente në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, në rastet kur përbëjnë vepër penale, dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.”⁴⁴

Kapitulli i pestë i ligjit për barazi gjinore përfshin një çështje shumë të rëndësishme që janë sanksionet. Me anë të tyre mundësohet një zbatim më i madh i ligjit, sepse nëse nuk respektohen dispozitat e shkruara ligjore pason dënimi i caktuar. Neni 23 shqipton sanksionet, ku theksohet gjopa prej 300 deri në 500 euro për personin që ka kryer diskriminim në bazë gjinore në sektorin publik ose privat. Gjorbë prej 500 deri në 700 euro do u shqiptohen atyre personave ose organeve që në formë të profesionit të regjistruar kryejnë veprimtari që në bazë gjinore shkelin dinjitetin e një personi ose krijojnë një mjedis të papërshtatshëm, fyes ose poshtërues. Gjorbë prej 700 deri në 900 euro do u shqiptohet personave që bëjnë diskriminim të barabartë ose të tërthortë gjinor ose nuk e bëjnë promovimin e barazisë gjinore në mjediset ku punojnë. Ndërsa gjorbë prej 300 deri në 500 euro do ketë për personat, organet apo institucionet përgjegjëse që nuk grumbullojnë, evidentojnë dhe përpunojnë të dhëna statistikore të ndara në bazë gjinore dhe nuk i dorëzojnë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Dhe gjitha këto mjete të mbledhura nga këto gjopa dorëzohen në buxhetin e Republikës së Kosovës.⁴⁵

Kapitulli i gjashtë njëherit edhe kapitulli i fundit i ligjit për barazi gjinore të Republikës së Kosovës përmban në vete tri nene. Neni 24 që përfshin nxerrjen e akteve ligjore, ku me propozimin e agjencisë për barazi gjinore, qeveria do t’i miratojë aktet nënligjore në afat prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të ligjit kryesor.⁴⁶ Ndërsa neni 25 përmban shfuqizimet. Ky ligj shfuqizon këto ligje të mëhershme: “Ligjin nr. 2004/2 për barazi gjinore”; “Rregulloren e UNMIK-ut me numër 2004/18 mbi shpalljen e ligjit për barazi gjinore”; “Urdhëresën administrative nr. 2007/3 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/19 mbi degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes”; “Rregulloren nr.1/2006 për themelimin, kompetencat dhe detyrat e Këshillit ndërministror për barazi gjinore” dhe

⁴³ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli IV, “Trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi në baza gjinore në fushën e arsimit”, Neni 21/ Edukimi për barazinë gjinore, Prishtinë, 2015, fq.13,14.

⁴⁴ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli IV, “Trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi në baza gjinore në fushën e arsimit”, Neni 22/ Mbrojtja juridike e të drejtës së trajtimit të barabartë të femrave dhe meshkujve, Prishtinë, 2015, fq.14.

⁴⁵ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli V, “Sanksionet”, Neni 23/ Dispozita kundërvajtëse, Prishtinë, 2015, fq.14.

⁴⁶ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli VI, “Dispozitat Përfundimtare”, Neni 24/ Nxjerrja e akteve nënligjore, Prishtinë, 2015, fq.15.

“Udhëzimin Administrativ MAPL Nr.2005/8 për përcaktimin e kompetencave dhe detyrave për zyrtarët/ët për barazi gjinore në komuna”.⁴⁷

Dhe neni i fundit, neni 26, përmban hyrjen në fuqi. Si çdo ligj tjetër i Republikës së Kosovës ashtu edhe ky ligj për Barazi Gjinore, do hyjë në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.⁴⁸

Fatmirësisht, në Republikën e Kosovës ekziston ligji për barazi gjinore mirëpo zbatimi i këtij ligji lë shumë për të dëshiruar. Qytetarët e Kosovës pak i binden këtij ligji, por mungon edhe mbikëqyrje e duhur dhe vëzhgim i plotë nga institucionet përkatëse. Prandaj, në Kosovë prapë duhet që të punohet fort për çështjen e barazisë dhe ky ligj bashkë me këto nene të përpiluara bukur të mos mbesin vetëm në letër por të aplikohen në praktikë.

Qëndrimet mbi rolin e gruas në familje dhe në shoqëri

Sa i përket rolit të gruas në familje dhe shoqëri, është e dukshme se luan një rol vërtetë thelbësor pasi është shtylla e familjes dhe baza e një shoqërie të shëndoshë. Mirëpo, jo gjithmonë gruaja dhe roli i saj shoqëror është konceptuar në mënyrën e njejtë. Historikisht, meritat e saj si shtyllë e fortë e shoqërisë shpesh janë hedhur poshtë e nuk janë pranuar, e shpesh ka ndodhur e kundërta, duke u vlerësuar dhe duke u vënë në pah meritat dhe sakrificat. Kjo tregon se qëndrimet ndaj rolit të gruas në familje dhe në shoqëri kanë qenë të ndryshme, mirëpo kryesisht ka mbizotëruar tendenca jovlerësuese ndaj rolit të gruas dhe limitimi i fushave ku ajo mund të japë kontribut ose të shprehë vetvetën.

Prej më herët e duke vazhduar edhe sot, gruaja shihet në rolin e një bashkëshorteje, nëne dhe të një shtëpiakeje, ku vështirë lihet vend për karrierën apo jetën sociale që mund të dojë një grua ta zhvillojë. Gruaja duhet të jetë personi që ndihmon bashkëshortin të arrijë diçka, të qëndrojë pas sukseseve të tij, të durojë krizat dhe tensionet që ai mund të ketë, ta motivojë dhe të jetë e devotshme ndaj tij, pa menduar për veten ose për ato çfarë ajo do mund të arrijë. Poashtu, gruaja duhet të jetë nëna e përkushtuar ditën dhe natën, duke u kujdesur pas fëmijëve edhe kur ata të bëhen të zotët e vetvetës dhe t’ua kushtojë krejt jetën atyre, poashtu të jetë shtëpiake e përkryer, duke fshirë e gatuar, duke vizëlluar shtëpinë dhe duke shkrirë vetvetën për të mos u munguar diçka të tjerëve. Mirëpo, kjo mund të thuhet se është e vështirë, është e dhimbshme dhe fatkeqësisht është dukuri aktuale. Edhe gruaja ka të drejtën të jetojë si të dojë, të ndajë kohë për vetvetën, të bëjë karrierë të vetën, të ketë jetë sociale, të bëjë më pak punë për të kënaqur të tjerët dhe të jetë e lirë nga paragjykimet dhe stereotipet historikisht të trashëguara mbi të.

Mirëpo, gratë sot përkundër barrierave të shumta, përpiqen që me aq pak kohë sa kanë në dispozicion për vetën, të gjejnë mundësinë për të punuar dhe për të ndërtuar një karrierë të tyren.

⁴⁷ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli VI, “Dispozitat Përfundimtare”, Neni 25/ Shfuqizimet, Prishtinë, 2015, fq.15.

⁴⁸ “Ligji për Barazi Gjinore”, Kapitulli VI, “Dispozitat Përfundimtare”, Neni 26/ Hyrja në fuqi, Prishtinë, 2015, fq.15.

Gratë kanë më shumë përgjegjësi sesa burrat. Nëse arrijnë të punojnë, ato duhet të bartin përgjegjësinë për mbarëvajtjen e jetës familjare por edhe për punën që kryejnë jashtë shtëpisë. Një grua ka role të ndryshme, së pari si një pjestare e komunitetit, shtetase e një vendi dhe pjesëmarrëse në fuqinë punëtore. Pastaj, kanë rolin e brendshëm dhe rolin e jashtëm.⁴⁹ Me rol të brendshëm të një gruaje kuptohet roli që luan ajo brenda familjes. Pra, nënkuptohet roli i bashkëshortes, nënës, nuses së familjes, shtëpiakes dhe asaj që përkujdeset për mirëqenien e gjithë familjes. Ndërsa roli i jashtëm i një gruaje nënkupton karrierën dhe arritjet profesionale, përkatësisht arritjet dhe përgjegjësitë që ajo i ka jashtë ambientit shtëpiak. Mirëpo, nëse gruaja ka karrierë (rol të jashtëm) atëherë ajo duhet të bëjë kujdes nga faktori i neglizhencës. Neglizhenca shkakton imbalanc dhe shkatërron përfundimisht njërin nga dy rolet që bart gruaja. Pastaj, kjo qon ose në shkatërrim të karrierës (thyerje profesionale) ose në shkatërrim të familjes (divorc). Duhet ditur se mbajtja e të dy roleve është sfidë mirëpo nuk është e pamundur, arrihet vetëm me përkushtim, me mirëkuptim nga bashkëshorti dhe familja dhe me vullnet të fortë. Sepse po të mos ishte kështu, atëherë gjitha gratë e martuara do rrinin në shtëpi dhe gjitha ato që duan karrierën nuk do martoheshin asnjëherë.⁵⁰ Pra, është e rëndësishme që familja fillimisht të japë mbështetje ndaj gruas dhe ta inkurajojë drejt karrierës, por kur e merr mbështetjen duhet që edhe gruaja pastaj të balancojë sferen personale dhe atë profesionale, pa harruar në asnjërin përgjegjësitë që i takojnë t'i kryejë.

Synimet dhe vizioni i një gruaje për jetën që do bëjë varet shumë edhe nga fryma me të cilën janë rritur në familje. Nëse prindërit i kanë nxitur drejt shkollës dhe diturisë, duke i inkurajuar drejt pavarësisë dhe punës, apo nëse i kanë privuar nga të drejtat e tyre dhe liria për të zgjedhur jetën që duan të bëjnë dhe prioritetet që duan t'i vendosin.

Megjithatë, janë disa situata të ndryshme ku gruaja mund të gjindet gjatë jetës: ajo mund të zgjedhë të zhvillojë talentin e saj, të ndjekë idealet që ka, dhe t'i dedikohet plotësisht vetes së saj përgjatë gjithë jetës, të arrijë aty ku ëndërron; ajo mund t'ia dedikojë vetën e saj plotësisht familjes dhe shtëpisë por të jetë e palumtur me zgjedhjen që ka bërë; situata tjetër është kur gruaja zgjedh karrierën mbi familjen që ka krijuar dhe kjo e drejton nga divorci dhe e fundit kur gruaja arrin të gjejë balancin mes familjes dhe karrierës, duke u dhënë të dyjave kohën dhe rëndësinë që meritojnë.⁵¹

Historikisht gratë kanë gatuar, janë kujdesur për fëmijët dhe shtëpinë, dhe një grua ka qenë aq e lirë sa burri i saj ka pranuar t'i japi të drejta asaj. Kjo sepse roli i një mashkulli tradicionalisht ka qenë mbizotërues në shoqëri, dhe ka qenë ai që ka punuar dhe ka mbajtur familjen. Mirëpo gjërat kanë marrë kahje më përparimtare kur edhe femrat filluan t'i qasen punës dhe jetës pak më sociale, të interesohen për vete dhe për mirëqenien e tyre, duke tentuar ta mposhtin inferioritetin shumë shekullor në shoqëri. Sot përkundër përpjekjeve të shumta gratë nuk arrijnë të gëzojnë

⁴⁹ Lantara NF, "The Roles of Woman as Leader and Housewife", 2015, J Def Manag 5, fq.2.

⁵⁰ Lantara NF, "The Roles of Woman as Leader and Housewife", 2015, J Def Manag 5, fq.3.

⁵¹ Ibid.

barazinë e njëjtë më meshkujt pothuajse në asnjë sferë të jetës. Nuk duhet harruar se jeta e një gruaje është shumë më e komplikuar se ajo e një burri. Gruaja nuk ka përgjegjësi vetëm për jetën e saj, por duhet të kujdeset edhe për anëtarët e tjerë të familje që atyre të mos ju mungojë gjë, t'i ndihmojë dhe t'i mbështesë shpirtërisht, tu lehtësojë jetën në çdo lloj mënyre, dhe pastaj të mendojnë edhe për karrierë ose për punë.

Një autore shumë e spikatur që vlen të përmendet kur trajtohet çështja e femrave dhe roli i tyre në shoqëri është Simone de Beauvoir. Ajo ishte themeluesja e konceptit të gruas moderne të shekullit XX dhe kishte mendime të pavarura rreth raportit mashkull-femer, ku thoshte se dy gjinitë janë të ndryshme por duhet të jenë të barabarta. Madje shprehej se punët dhe rutina shtëpiake e humbin talentin e një gruaje dhe ambienti shtëpiak nuk duhet të jetë vendi ku një grua ta kalojë gjithë jetën e saj. Roli i një gruaje nuk është vetëm roli riprodhues dhe punësimi i saj është rrugë drejt lirisë. Kjo poashtu ishte pro legalizimit të abortit dhe nuk e shihte martesën si të vetmen rrugë për një jetë të mirë. “Në një botë të sotme, fati normal i femrës është martesë, që nënkupton praktikisht nënshtrimin ndaj mashkullit, prestigji i të cilit është larg zhdukjes duke qëndruar ende mbi themele të forta ekonomike dhe sociale”.⁵²

Autorja shprehej se kishte lexuar shumë gjatë jetës së saj dhe ishte njoftuar me kultura të ndryshme dhe mënyra të ndryshme të jetesës. Kjo e kishte ushqyer shpirtin e saj duke ia mundësuar të ndërtonte mendimet e saja rreth jetës dhe mënyrës se si një femër duhet të trajtohet por njëkohësisht të luftojë për veten dhe qënien e saj. Ajo ia kishte arritur të jetonte një jetë pa barriera, ku e çmonte lirinë si gjënë më të çmuar të saj. Sipas saj, “grua nuk lind por bëhesh. Asnjë gjini biologjike, psikologjike apo ekonomike nuk përcakton figurën që femra njerëzore paraqet në shoqëri; është qytetërimi si një e tërë që prodhon këtë krijesë, mesatare midis meshkujve dhe eunukëve, e cila përshkruhet si femërore”.⁵³ Beauvoir sqaron teorinë e reciprocitetit ku thotë se as meshkujt dhe as femrat nuk bëjnë dot pa njëri tjetrin sepse përndryshe nuk do kishte jetë mbi tokë, mirëpo patriarkati ka qenë privues i madh dhe vazhdon të jetë lidhur me lirinë dhe avancimin e femrës.⁵⁴

Në të kaluarën familjet tradicionale tentonin të paraqiteshin si të lumtura, mirëpo lidhjet personale brenda familjes nuk ishin të forta. Kjo sepse gratë ishin të shtypura dhe jo të kënaqura me jetën që bënin ndërkohë burrat që ishin të favorizuar nga koha dhe shoqëria, ishin të lirë të jetonin jetën ashtu siç ata donin. Në institucionin e martesës, luanin rol të fuqishëm faktorët e jashtëm dhe fuqia detyruese e tyre, traditat shoqërore dhe veqanarisht ritet fetare. Më herët thuhej se sa herë që i është dhënë gruas e drejta të punojë ose të përfshihet në ndonjë organizatë, një tjetër botë është ngjallur në sytë e saj. Ajo ka harruar familjen dhe punët e shtëpisë, dhe gjithë energjinë e saj e ka fokusuar në një vatër të re. Përfundimisht, prishen marrëdhëniet në familje sepse mungon vëmendja dhe përkushtimi, dhe vjen ndarja.⁵⁵

⁵² Beauvoir, Simone, “The Second Sex”, Jonathan Cape Publishing, 1953, Londër, fq.29.

⁵³ Ibid, fq.273.

⁵⁴ Ibid, fq.20.

⁵⁵ Trotsky, Leon, “Women and Family”, Pathfinder Press, 1970, SHBA, fq.27.

Mirëpo sot kemi evolimin në një lloj të ri të familjes. Edhe pse prapë mënyra si trajtohet gruaja në shoqëri lë shumë për të dëshiruar, mirëpo qëllimi dhe lidhja më e ngushtë bashkëshortore, largimi i imponimeve familjare dhe zbehja e partiarkatit, ka bërë që të ngritet standardi kulturor jetësor i burrit dhe gruas. Kjo do të thotë që jo gjithçka të kërkohej të kryhet nga gruaja në familje, por secili anëtar të ketë dicitplinë të brendshme dhe të jetë më i përgjegjshëm për veten.⁵⁶ Si gratë ashtu edhe burrat, nga kjo perspektivë, duhet të kenë të drejtën dhe mundësinë për të sfiduar shtypjen duke refuzuar ose transformuar rolet e përcaktuara brenda shoqërisë. Kjo përfshin të drejtën e grave dhe burrave për të sfiduar dhe transformuar ndarjet gjinore të vjetra dhe jofunksionale të punës dhe për të zhvilluar norma të reja të relacioneve njerëzore dhe solidaritetit shoqëror.⁵⁷ Nëpër vende të ndryshme të botës ekzistojnë forma të ndryshme të fuqizimit të gruas, ose emancipimit të saj në shoqëri. Një formë e cila mund të përmendet është autonomia, që njëherit konsiderohet edhe element integral për fuqizimin e gruas në shoqëri. Autonomia mund të përkufizohet si “aftësia dhe liria për të vendosur, për të dhënë mendimin dhe për të vepruar”.⁵⁸

Megjithatë, gratë që mund të kenë mundësinë të punojnë ose të ndërtojnë karrierë, prapë kanë problemin tjetër se duhet të përshtaten në një botë ku rregullat tashme janë vendosur nga bota mashkullore. Ato në punë duhet të përpiqen të sillen ashtu siç kërkohej, duhet të kujdesen për orarin strikt përkundër se përveq punës kanë edhe trefishin e përgjegjësisë në familje, dhe me pak fjalë puna dhe karriera nuk kërkojnë justifikime. Mirëpo gratë jo gjithmonë i qëndrojnë natyrës së qetë dhe femërore. Halpern and Cheung shprehin: “Mbaj mend ditët në Wall Street ku gratë dilnin nga vetja dhe silleshin si burra. Diskutimin me zë të lartë në mbledhje, taman si burrat, por gratë kanë mënyrën e tyre të të bërit biznes dhe nuk është i njëjtë si ai i burrave. Drejtorët nuk i lënë punëtoret të kalojnë shumë kohë në shtëpi për shkak të orareve të gjata. Bile një grua tha që kishte dalë në zyrë dy ditë pas lindjes. Mirëpo pse gratë e lejojnë këtë? Natyrisht që Wall Street dominohet nga burrat por nuk do të thotë që gratë që punojnë aty të luajnë sipas rregullave që meshkujt kanë vendosur në fushë. Si rrjedhojë është gabim mendimi i disa grave që shprehen se nëse dua karrierë dhe të jem konkurese në punë nuk duhet të martohem dhe të krijoj familje. Kjo është shumë gabim sepse vlerë dhe rritje e madhe i shtohet gruas kur bëhet grua dhe nënë, mirëpo nuk duhet të harrojmë që për të qenë e barabartë me burrat duhet të punojë në stilin profesional femëror pa i hedhur poshtë cilësitë e buta të natyrës femërore”.⁵⁹

Mirëpo, ne shqipëtarët si shoqëri prapë jemi shumë më mbrapa me konceptin e punës së gruas, dhe ngulitemi fort mbi rolin e saj qëndror në familje. Më së miri kjo mund të shprehet në citimin në vazhdim: “Në traditën shqiptare ka patur gjithnjë disa ndarje rolesh mes gjinive. Shpesh burri

⁵⁶ Ibid, fq.29.

⁵⁷ Nagendra, Shilaja, “Women’s Role in Modern World”, ABD Publishers, 2008, Jaipur, fq.276

⁵⁸ Nagendra, Shilaja, “Women’s Role in Modern World”, ABD Publishers, 2008, Jaipur, fq.277.

⁵⁹ Halpern, Diane & Cheung, Fanny, “Women at the Top: Powerful Leaders Tell Us How to Combine Work and Family”, Willey-Blackwell Publications, 2008, Oxford, fq.1-2.

është quajtur “shtylla e shtëpisë” dhe gruaja “zonja e shtëpisë”. Këto kanë tingëlluar gjithnjë si një lloj ndarje hirarkike e punëve të shtëpisë ku terminologjia mbartte në fakt pozitivizëm. Zakonisht familja shqiptare ishte e madhe dhe me disa breza. Kuptohet se si e tillë, dy termat i përkisnin më të vjetërve të dy gjinive. Megjithatë, meqënëse aspekti financiar jashtë e brenda shtëpisë u takonte burrave, “zonja e shtëpisë” kishte të drejta administrimi mbi punët e përditshme brenda shtëpisë, ku përfshiheshin edhe aspekte të përditshme financiare apo administrimi dhe ndarja e punëve midis grave të tjera, vajzave, djemve, mbesave, nipërve etj. Edhe brenda këtyre roleve dhe termave të jetës së përditshme ekziston e fshehur ndarja midis rolit të burrit në familje dhe punës së papaguar femërore në shtëpi”.⁶⁰ Por, fatmirësisht sot shihet nevoja që kontributet shtëpiake të barazohen, pra edhe burrat edhe gratë të pasurojnë buxhetin familjar në mënyrë që të bëjnë jetë më të mirë. Pra, nganjëherë gratë për të plotësuar nevojat e familjes duhet të punojnë. Kështu që çiftet pajtohen me raste të marrin edhe persona të tretë (kujdestare ose dado) që të mirëmbajnë shtëpinë dhe të kujdeset për fëmijet. Pra, “kjo mund të jetë një avancim drejt zvogëlimit sado pak të peshës së madhe që një grua mban mbi supet në momentin që vendosë të punojë ose të bëjë karrierë. Por në anën tjetër, sot gratë jo rrallë përpiqen të krijojnë familje me një fëmijë, me qëllim që përgjegjësia prindërore të jetë më e vogël, me qëllim që t’i dedikohen punës, ngritjes profesionale dhe karrierës së tyre”.⁶¹

Inkuadrimi dhe përfshirja e gruas në fuqinë punëtore të një shteti ka vërtetë rëndësi të madhe. Zhvillimi ekonomik i një vendi varet nga forcat e prodhimit – puna, kapitali dhe toka. Një zhvillim i qëndrueshëm arrihet kur investohet në kapitalin ekonomik, njerëzor dhe atë mjedisor. Kur themi investim në kapitalin njerëzor nënkuptohet përdorimi më racional dhe sa më i madh i fuqisë punëtore. Mirëpo, në shumë shoqëri patriarkale dhe që udhëhiqen nga tradita dhe zakonet e vjetra, femrat nuk punojnë. Kjo nënkupton se pasivizohet gjysma e kapitalit njerëzor si faktor i prodhimit, dhe femrat nuk kanë mundësi të kontribojnë në zhvillimin ekonomik të shtetit por as në mirëqenien e tyre personale dhe në ngritjen e standardit të jetesës.

Përdorimi i kapacitetit femëror si faktor i prodhimit në mënyrë të duhur mundëson rritjen ekonomike, zvogëlimin e varfërisë, rritjen e mirëqenies shoqërore dhe ndihmon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të shtetit. Fatkeqësisht, kapitali femëror ende nënvlerësohet nëpër vende të botës.⁶²

Integrimi i grave në udhëheqjen e shoqërisë dhe sistemeve të tjera të jetës njerëzore është duke u bërë e nevojshme. Mund të thuhet se edhe femrat posedojnë ambicie si meshkujt, kanë vizione, kanë ide, synime dhe kanë karakteristika që i kërkojnë një punëtori të suksesshëm, por për dallim nga meshkujt, femrat përplasen në barriera të shumta, në mure të larta, që ua vështirësojnë rrugëtimin drejt përmbushjes së qëllimeve.

⁶⁰ Semini-Tutulani, Mariana, “Konfliktet gjyqësore të marrëdhënieve të punës parë nën perspektivën e barazisë gjinore”, Shkolla e Magjistraturës & UNDP, Tiranë, 2013, fq.23.

⁶¹ Ibid, fq.22.

⁶² “Gender and Sustainable Development-Maximising the economic, social and environmental role of women”, OECD, 2008, fq.7. <https://www.oecd.org/social/40881538.pdf>

Gloria Steinem, gazetare dhe aktiviste politike, shprehet: “Femrat thonë gjithmonë: Ne mund të bëjmë gjithçka që mund të bëjnë dhe meshkujt. Por janë meshkujt ata që duhet të thonë: Ne mund të bëjmë gjithçka që mund të bëjnë dhe femrat. Kjo shprehje është shumë aktuale sepse femrat janë ato që vazhdimisht vihen në provë dhe duhet të vërtetojnë se mund t’ia dalin dhe të arrijnë të kapin nivelin e një mashkulli, kur në fakt mashkulli duhet të mundohet t’ia dalë ashtu siç ia del një femër kundrejt sfidave dhe vështirësive që e rrethojnë. Autorja e njejtë thotë që “kemi për të dëgjuar meshkujt tek kërkojnë këshilla nga gratë se si të kombinojmë suksesshëm martesën dhe karrierën”.

I. Pjesëmarrja e grave në politikën e Kosovës

Për një vend demokratik, pjesëmarrja politike e popullatës është shumë e rëndësishme, duke përfshirë aty edhe pjesëmarrjen e konsiderueshme mashkullore edhe atë femërore. Mirëpo, nëse flitet për Kosovën, është e dukshme se pjesëmarrja politike e gruas është në nivel jo të kënaqshëm.

Duke qenë se gratë përbëjnë gjysmën e popullatës, ato janë një shtyllë e rëndësishme e shoqërisë njerëzore dhe kanë të drejtat e tyre themelore. Shihet i nevojshëm inkudrimi dhe pjesëmarrja e tyre në politike sepse është një kusht për funksionimin më të mirë të shoqërisë, njëkohësisht edhe për një shoqëri sa më demokratike dhe vendimarrje më efikase. Në vendimarrje të një shteti është shumë e rëndësishme të dëgjohet zëri i grave sidomos për vendime që i prekin vetë ato.

Sipas një studimi të agjensisë për barazi gjinore në Kosovë, pjesëmarrja e grave në vendimarrje në Kosovë konsiderohet të jetë e vogël përkundër kërkesës ligjore nga Ligji për Barazi Gjinore që thekson se “përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse”.⁶³

Duke marrë parasysh detyrimin ligjor për të siguruar barazi gjinore në të gjitha aspektet e jetës në Kosovë, një rëndësi më e madhe duhet t’i kushtohet përfshirjes së grave në vendimarrje. E drejta për barazi të grave dhe burrave kërkon që autoritetet lokale dhe rajonale t’i marrin të gjitha masat e duhura dhe të miratojnë strategjitë e përshtatshme për të promovuar përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në të gjitha sferat e vendimarrjes.⁶⁴

⁶³ Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, Kapitulli I, “Dispozitat Ligjore”, Neni 6/ Masat e veçanta, Pika 8, Prishtinë, 2015, fq.6.

⁶⁴ “Pjesëmarrja e grave në vendimarrje në Kosovë”, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 2016, Prishtinë, fq.11

Lufta për të arritur barazinë gjinore është luftë e vazhdueshme dhe jo vetëm në politike por në të gjitha sferat jetësore. Barazia gjinore lidhet me nocionet themelore për cilësinë e drejtësisë shoqërore, të drejtat e njeriut dhe natyrën e demokracisë. Madje “përfshirja e dy gjinive në hartimin e politikave e bën këtë proces më cilësor, që përkon më mirë me një publik të larmishëm dhe bën që në kalendarin e politikave të përfshihen çështje të harruara ose të reja”.⁶⁵

Në deklaratën e Athinës të vitit 1992 thuhet se “gratë përfaqësojnë gjysmën e talenteve dhe aftësive potenciale të njerëzimit dhe nënperfaqësimi tyre në marrjen e vendimeve është një humbje për shoqërinë në tërësi”.⁶⁶ Prandaj, përgjithësisht përfshirja e gruas në jetën politike ka rëndësi dhe përfitim shoqëror dhe ekonomik. Mirëpo, kjo mbetet një sfidë e madhe për zhvillimin e demokracisë sonë. Përfaqësimi i grave në politikë dhe në vendimmarrje vazhdon të jetë proces i ngadaltë. Duhet marrë veprime dhe programe strategjike nga ana e shtetit për të përmirësuar situatën aktuale.

1.1. Pjesëmarrja e gruas në votime

Çështja e pjesëmarrjes së gruas në votime mund të konsiderohet si një çështje që ka mbetur mes traditës dhe modernitetit. Votimi është pjesë e rëndësishme jo vetëm për determinim të jetës politike por edhe për përcaktimin e jetës shoqërore që do zhvillohet. Mirëpo pjesëmarrja në votime shihet edhe më tepër si çështje mashkullore ku meshkujt do vendosin se kush do jetë i votuari nga familja dhe pjesëmarrjen e grave nuk e shohin fort të nevojshme. Nëse rritet pjesëmarrja politike e gruas në Kosovë, gruaja do ndihet se ka peshë në politikën kosovare, do ta vlerësojë të drejtën e votës së saj, do vendosë vetë se për kë të votojë dhe nuk do ta konsiderojë votimin më shumë si një çështje të baballarëve, bashkëshortëve dhe vëllezërve, por pjesë të rëndësishme të rolit të saj si grua.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) ka bërë një hulumtim, ku përmes grave respondente ka arritur në përfundim se gratë që votojnë janë votuese stabile. Ato kryesisht kanë zakon që t’i analizojnë sado pak programet dhe premtimet zgjedhore të partive. Njëkohësisht, ato kanë deklaruar se aspekti gjinor, respektivisht angazhimi i partive të preferuara në çështjet e të drejtave të grave dhe të barazisë gjinore - nuk janë kriteri kryesor në vendimin për ta votuar një parti të caktuar. Mirëpo, një analizë më e thellë tregon se nganjëherë vetë gratë janë pengesë e avancimit të tyre drejtë progresit në shoqëri.⁶⁷ Sipas raportit, arsyet mund të jenë të ndryshme: ato mund të jenë të influencuara nga dikush për të dhënë votën e tyre për shembull nga meshkujt në familje që simpatizojnë një parti, ose ato vetë mund të kenë besim më të madh në liderin e një partie, ose siç ndodh shpesh japin votën për një parti ku kanë dikë të afërm ose të njohur. Pra,

⁶⁵ Ibid, fq.14.

⁶⁶ Deklaratë e nënshkruar nga gratë ministre të vendeve anëtare të BE-së në Samitin e Parë European për Gruan në Marrjen e Vendimeve, Athinë, 3 nëntor 1992.

⁶⁷ “Si votojnë gratë në Kosovë”, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 2014, Prishtinë, fq.6

pothuajse në gjitha anët del diçka që në një mënyrë ose tjetrën ia imponon një gruaje se kujt t'ia hedhë votën, pa ia lënë mundësinë të vërë vetën në vijën e parë të prioritetit.⁶⁸

Mostra e hulumtimit të QKSGJ-së ishte 1050 gra dhe vajza, prej tyre janë anketuar 49,9 për qind në fshatra dhe 47,3 për qind në qytete, ndërsa 2,6 për qind në qyteza. Sa i përket statusit martesor, 66,6 për qind ishin të martuara, të pamartuara ishin 30,4 për qind, ndërsa të veja 2,7 për qind. Niveli i shkollimit të grave dhe vajzave në Kosovë mbetet sfidë për institucionet e arsimit në Kosovë për faktin se vetëm 15 për qind e respondentëve thanë se e kanë të kryer shkollimin universitar, ndërsa 37,1 për qind kishin shkollim të mesëm. Deklarimi i mbi 14 për qind të të anketuarave se aktualisht ishin studente verifikonte përqindjen e të diplomuarave dhe njëkohësisht dëshmonte mungesën e progresit drejt rritjes së numrit të vajzave me diplomë universitare. 28,9 për qind e respondentëve kishin deklaruar se janë me shkollim fillor, 1,8 për qind me master, 0,3 për qind me doktoratë dhe 2,3 për qind janë pa asnjë vit shkollë.⁶⁹ Kjo situatë në fushën e arsimit reflektohet dukshëm në një mirëqenie më të ulët sociale dhe në një pozitë të vështirë ekonomike për gratë në Kosovë.

Gratë dhe vajzat e Kosovës pjesëmarrëse në hulumtim, janë shprehur se dalin në votime sepse presin nga të zgjedhurit të rregullojnë dy grupe çështjesh, ku grupi i parë i çështjeve përfshinte: rritjen e zhvillimit ekonomik, zhdukjen e varfërisë dhe finalizimin e dialogut Kosovë-Serbi. Ndërsa grupi i dytë i çështjeve ishin: papunësia, reduktimi i korrupsionit dhe zhdukja e krimit të organizuar.⁷⁰

Në disa raste gratë e anketuara shfaqnin tendencë për qëndrime tradicionale lidhur me rolin e grave në shoqëri, posaçërisht në politikë, pasi një numër i madh i tyre mendonin se gratë e kanë më të rëndësishme familjen se karrierën politike. Por në anën tjetër, ato gjithashtu shprehën pikëpamje progresive duke shfaqur nevojën e rritjes së numrit të grave të përfshira në politikë dhe vendimmarrje, ku 40 për qind e tyre janë deklaruar se “rreth gjysma e pozitive vendimmarrëse duhet t’iu takojnë grave”.⁷¹

Votimi familjar dhe gratë që nuk votojnë janë dy çështjet kryesore shqetësuese. Për shkak të ndikim negativ të gratë, votimi familjar vazhdon të jetë një nga problemet themelore të praktikave të votimit në Kosovë. Kjo sepse privon gratë nga mundësia për të zgjedhur vetë dhe për të hedhur votën sipas vullnetit të tyre. Mirëpo, edhe gratë që nuk votojnë veprojnë kështu shkaku i imponimit ose mosbesimit se vota e tyre mund të bëjë ndryshimin. Konsiderohet që çdo e treta grua shkon në vendvotime.⁷²

⁶⁸ Ibid.

⁶⁹ Ibid, fq.12.

⁷⁰ Ibid, fq.7.

⁷¹ Ibid, fq.8.

⁷² “Gratë në politikë dhe qeverisje: Perceptimet e të rinjve/të rejave”, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, 2018, Prishtinë, fq.14.

Vlen të përmendet rasti i zgjedhjeve të vitit 2013 në Kosovë, kur pjesëmarrja e grave në votime e ka tejkaluar atë të burrave në të gjitha përveç dy komunave në Kosovë (Skenderaj dhe Drenas). Kjo shënoi herën e parë në historinë zgjedhore të Kosovës që më shumë gra se burra hodhën votën. Situata ndryshoi në zgjedhjet parlamentare të 2014-ës, në të cilat gati 15 për qind më pak gra votuan krahasuar me zgjedhjet lokale të 2013-ës.⁷³

1.2. Pjesëmarrja e gruas në aktivitete politike

Përgjithësisht mund të thuhet se pjesëmarrja e gruas në aktivitete politike nuk qëndron në një nivel të kënaqshëm në Kosovë. Pjesëmarrja në politikë përfshin aktivitete të shumëllojta si votimi në zgjedhje, angazhimi në fushata zgjedhore, anëtarësia aktive në parti politike dhe shoqata lobuese, kontaktimi i politikanëve, dalja në protesta dhe tubime tjera publike, nënshkrimi i peticioneve etj.

Gratë edhe në të kaluarën edhe sot përballen me diskriminime në punësim, kanë rroga dhe të ardhura më të ulëta për punën që bëjnë, dhe fakti që nuk mirren edhe fort seriozisht në politikë bën që mos të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme politike. Por, vërehet edhe tendenca që partitë më të mëdha nuk u japin shumë hapësira grave për të shfaqur veten, përderisa partitë më të reja insistojnë në një angazhim me të madh të grave në aktivitetet politike. Mirëpo, edhe nëse sigurohen hapësirat e nevojshme për depërtimin e grave prapë shfaqen barrierat për kandidim, financimi i kandidaturës së saj dhe fushatës zgjedhore përkatëse. Gjithashtu, edhe vetë angazhimi në fushatë zgjedhore është vështirësi në vete për gruan sepse kërkon përkushtim, kohë, impenjim dhe duhet marrë seriozisht me qëllim të arritjes së objektivave të vendosura. Pastaj, edhe kontaktet me politikanë tjerë duhen të jenë sa më të rezervuara, duke bashkëpunuar por edhe duke mbajtur distancat. Dalja në protesta dhe në tubime të ndryshme është tepër me rëndësi për një grua që synon lart në politikë, sepse në njëfarë mënyre mbështet për se afërmi dhe publikisht një nismë apo çështje. Mirëpo, nëse ajo nguron të bëhet pjesë e turmës, ose nguron të marshojë ashtu publikisht, atëherë nuk është gati për të marrë ndoshta përgjegjësi tjera sepse pastaj populli do jetë ai që do ngurojë në raport me atë grua ose edhe me të tjera sikur ajo.

Duhet theksuar se edhe në të kaluarën, gruaja kosovare ka qenë aktive në çdo pore të jetës, si: organizatore e pjesëmarrëse të protestave kundër ndryshimeve kushtetuese, pjesëmarrëse aktive të demonstratave të vitit 1989, pjesëtare e denjë në Kuvendin e Kosovës, ku me trimëri ngriti gishtat dhe votoi kundër Serbisë okupuese, dhe pse e dinte se dyert e burgut i kishte të hapura.⁷⁴ Me pak fjalë, gratë edhe pse sot ndoshta mënjanohej ose nuk inkurajohen për pjesëmarrje në aktivitete politike, në të kaluarën me aq sa kanë pasur mundësi kanë kontribuar për vendin e tyre, ndonëse mjedisi kosovar as nuk ka qenë e as nuk është i lehtë për të depërtuar e për të kontribuar.

⁷³ “Kosovë: Tejkalmi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë”, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), 2015, Prishtinë, fq.10.

⁷⁴ Keçmezi-Basha, Sabile, “Feja Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarë” (simpozium ndërkombëtar), Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 1995, fq.541.

Për shembull, Luljeta Pula Beqiri, një grua aktiviste ka folur publikisht se sa barriera të panumërta i dalin një gruaje në rrugën e saj drejt politikës. Ishte 16 vjeçe kur e filloi aktivitetin e saj politik. Ishin demonstratat e vitit 1968. Në atë vit Luljeta Pula Beqiri, e cila gati dy dekada më vonë do të bëhej njëra prej protagonistëve më të rëndësishme të jetës politike dhe shoqërore, në ato demonstrata po kërkonte për vendin e saj vetëvendosje dhe republikë. Ajo shprehej se prindërit - të dy të përkushtuar në arsim, e kishin edukuar atë me dashuri kombëtare, kishte mirëqenie në familje, dhe me inkuadrimin në politikë rrezikonte të humbiste shumëçka.⁷⁵

Angazhimi politik i kishte kushtuar me përjashtim nga gjimnazi po në të njëjtin vit kur u mbajtën demonstratat e vitit 1968, pavarësisht faktit se ishte nxënëse e shkëlqyer. Ajo në rrëfimin e gjatë për jetën e saj, thotë se kjo nuk e kishte ndalur që të vazhdonte rrugën në kërkim të të drejtave për shqiptarët. Në vitin 1981 kishte marrë pjesë në demonstrata duke e rrezikuar edhe punën si profesoreshë në univerzitet për të mbrojtur idealet e saja. Për shkak të atmosferës politike, kur u suprimua autonomia dhe terreni dukej se më shumë ishte bërë për burrat, ajo u gjend para sfidave të mëdha. Thotë se kontributi i grave ishte tendencë të mos çmohej përkundër se gratë mundoheshin të kontribonin me aq sa kishin mundësi.⁷⁶

Pula-Beqiri pajtohet se pas luftës janë krijuar kushte më të mira për depërtimin e grave në aktivitete politike, mirëpo ato vetë duhet të ndjekin rrugën e emancipimit dhe të luftojnë për të drejtat e tyre. Për më saktë, ajo shprehet: “Kur pas luftës u bë e ligjshme, legale dhe e aplikueshme e ashtuquajtura kuotë e grave për të imponuar një përfshirje të caktuar të grave medoemos në institucione, ndjeva vehten të fyer si grua.”⁷⁷ Ky sipas saj nuk ishte kontribut kundrejt emancipimit të grave. Sepse emancipimi nuk mund të bëhet me një dekret. Ai është proces të cilit duhet t’i kontribuojë vetë gruaja në veçanti dhe shoqëria në përgjithësi. “Kjo formulë e cila vazhdon të implementohet edhe sot, ofendon gruan, integritetin e saj dhe ngritjen e saj profesionale dhe intelektuale, e cila mohohet në parim dhe paragjykohet pa turp duke u pranuar si e tillë, për vetë faktin e përkatësisë gjinore”.⁷⁸

Ndërsa, një tjetër grua shumë aktive në sferën politike në Kosovë dhe pjesëmarrëse në aktivitete të shumta politike është Mimoza Kusari Lila. Ajo shprehet se “Ne si gra, mbase duhet të mësohemi me pritjet dhe vështirësitë, fitoret nuk na bëjnë të fortë. Çdo grua mund t’ia dalë nëse mendon dhe beson se mund ta bëjë”.⁷⁹

Nga eksperiencia e saj jetësore dhe nga sukseset e saja të shumta në sferën politike, mund të kuptohet se asnjëra prej grave nuk duhet të presë të marrë ftesë ose inkurajim për të marrë pjesë nëpër aktivitetet politike, por duhet që vetë të ketë vullnetin për të ecur përpara. Ka kryer

⁷⁵ Kalaja, Besa, “Rrëfimi i Luljeta Pula Beqirit mbi rrugëtimin e saj të gjatë në politikë”, Qershor 2019, Jahjaga Foundation, Prishtinë. <http://jahjagafoundation.org/index.php/2019/06/18/rrrefimi-i-luljeta-pula-beqirit-mbi-rrugetim-in-e-saj-te-gjate-ne-politike/>

⁷⁶ Ibid.

⁷⁷ Ibid.

⁷⁸ Ibid.

⁷⁹ Ahma, Liridona, “Kusari-Lila nuk e sheh të pamundshme udhëheqjen e politikës nga grate”, Qershor 2019, Jahjaga Foundation, Prishtinë. <https://jahjagafoundation.org/index.php/2019/06/13/kusari-lila-nuk-e-sheh-si-te-pamundshme-udheheqjen-e-politikes-nga-grate/>

fakultetin ekonomik në Prishtinë, por ndërkohë edhe ka punuar si libërmbajtëse në një depo private për të mbajtur familjen, ka fituar bursë për në Amerikë, është shkolluar atje dhe kur është kthyer në vendlindje, me bagazhin e saj akademik ka filluar punë në Bankën Botërore në Kosovë, pastaj në Ambasaden Amerikane si menaxhere e një projekti. Më pas, për tri vjet e gjysëm në zyren e Kryeministrit që pason si drejtoreshë në Odën Ekonomike Amerikane.⁸⁰ Në vitin 2009 kandidoi për kryetare të Komunës së Gjakovës ku edhe pse humbi ajo nuk u dorëzua. Në vitin 2013 u rikthye e vendosur për të rikandiduar për kryetare të Gjakovës. Edhe pse nuk e pati pëlqimin e familjes së ngushtë, ajo kishte synimet e veta që donte t'i arrinte. La postin e zv.Kryeministres dhe Ministres së Tregtisë për të ndjekur objektivat e saja politike, dhe ia doli me sukses.⁸¹

Shembulli i znj. Kusari-Lila paraqet një ndër shembujt më të mirë sepse grave kosovare ua ilustron më së miri faktin se duhet të kapin çdo mundësi që mund tu sjellë jeta, pa u zbrapsur nga shumica mashkullore, pa patur frikë se nuk janë mirë mjaftueshëm apo nuk janë të kualifikuara sa duhet. Vetë rrjedha e jetës politike të dëshmon se a je e aftë të qëndrosh në politikë apo jo, kështu që besoj që secila grua që e sheh veten të interesuar dhe të aftë për aktivitetet politike, i detyrohet vetes një mundësi, që të shikojnë deri ku mund të arrijnë dhe sa mund të përballojnë dinamikën e jetës politike.

Hezitimi i grave për t'u bërë pjesë të aktiviteteve politike nuk lidhet aq shumë me shkallën e arsimimit të tyre e as me mungesën e atributëve në karrierë por kjo varet më shumë nga faktorë socialë, kulturorë dhe ekonomikë, që nuk janë të lidhur me aftësitë e grave. Gjithashtu, fakti që ka më shumë burra se gra në politikë dhe meshkujt dominojnë edhe nëpër aktivitete të ndryshme politike, lidhet me zgjedhje personale.⁸² Duhet që gratë të kenë vullnetin dhe motivimin për të qenë pjesë e politikës, të japin kontribut me aq sa kanë mundësi e jo të privojnë veten nga mundësitë. Por, edhe duke marrë parasysh rëndësinë e pranuar të arsimit për pjesëmarrjen e grave në politikë, vendimmarrje dhe udhëheqje, është një e metë e madhe shoqërore që gratë në Kosovë janë prapa burrave në këtë fushë. Arsimimi konsiderohet si një nga faktorët më të rëndësishëm në fuqizimin e grave dhe përfundimisht në arritjen e barazisë gjinore. Rëndësia e arsimimit për pjesëmarrje dhe përfshirje në politikë është i pamohueshëm dhe njihet dhe potencohet në shumë konventa dhe konferenca ndërkombëtare. Shifrat tregojnë se ka dallime në çdo nivel të arsimit. Për më tepër, gratë e anketuara nga familje më të mëdha kanë më pak gjasa të jenë të arsimuara. Rrjedhimisht, mund të konstatohet se familjet më të mëdha i japin përparësi çështjeve të tjera shtëpiake para arsimimit të vajzave të tyre, apo arsimimi i djemve të tyre ka përparësi më të madhe ndaj asaj të vajzave. Një interpretim tjetër i mundshëm është se familjet më të mëdha përgjithësisht kanë shkollim më të ulët se familjet më të vogla.⁸³

⁸⁰ Ibid.

⁸¹ Ibid.

⁸² “Udhëheqja dhe pjesëmarrja e grave në politikë”, UNDP, 2014, Prishtinë, fq.14.

⁸³ Ibid, fq.20.

I.3. Pjesëmarrja e gruas si kandidate politike

Pabarazia mes meshkujve dhe femrave tashme nuk është një fenomen i ri në historinë e politikës kosovare. Kjo tregon se grave nuk do u hapet ndonjëherë rruga që të arrijnë pozitat e synuara por duhet që të forcojnë gjithnjë e më shumë vetëvlerësimin dhe vetëpërfaqësimin e tyre.

Sociologët mendojnë se gratë janë të papërfaqësuar në institucionet politike, sepse ato ende paragjykojnë për aftësitë drejtuese. Sipas tyre, përfaqësimi i grave në parlament duhet të jetë mbi 50 për qind, që ato të tregojnë realisht peshën dhe rolin e tyre në shoqërinë shqiptare.⁸⁴

Gratë nuk duhet të presin as kohën e zgjedhjeve dhe as premtimet partiake për barazi gjinore dhe mundësi ndaj grave, nuk duhet të fokusohen në fjalimet e deputetëve në parlament ku tërthorazi përmendin mbështetjen ndaj grave, por duhet që vetë të thurin planin e suksesit dhe involvimit të tyre, duke mos pritur as aprovimin e as mbështetjen e personave të tjerë.

Për një grua nuk është e lehtë të fitojë statusin e një kandidati politik, sepse gjithmonë ekzistojnë dyshime dhe standarde të dyfishta në lidhje me të. Mirëpo, nëse ajo ndan mendjen për t'i hyrë një rruge të tillë, strukturat shoqërore duke nisur nga familja, kanë nevojë për trajtimin e mentalitetit patriarkal dhe kundërshtimin e perceptimeve shoqërore për pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimmarrje; shoqëria duhet të njohë dhe të pranojë se ndarja e punës dhe e përgjegjësiwe familjare mes grave dhe burrave është kryesore për inkuadrimin e grave në politikë; institucionet arsimore duhet të zhvillojnë një kurrikulë për djemtë dhe vajzat ku avokohet dhe promovohet barazia gjinore, duke filluar nga mosha e hershme për t'u siguruar kështu që brezat e ardhshëm të jenë më pranues ndaj pjesëmarrjes së barabartë të grave; Mediat duhet të kenë mbulueshmëri të barabartë dhe të paanshme ndaj kandidateve femra para zgjedhjeve dhe pas tyre, duke ua mundësuar qasjen e duhur ndaj publikut.⁸⁵

Partitë politike duhet t'i rishikojnë strukturat partiake, agjendat dhe proceset e brendshme me qëllim që të identifikojnë dhe të trajtojnë elementet që pengojnë pjesëmarrjen e grave në politikë. Poashtu, partitë duhet të sigurojnë përfshirjen e prioriteteve gjinore në agjendat e tyre politike dhe të kontribuojnë në integrim gjinor. Udhëheqësit e partive politike duhet të sigurojnë mbështetje për gratë kandidate dhe të mos bëjnë bërë dallime mes tyre dhe kandidatëve burra. Barazia gjinore nuk duhet të diskutohet vetëm brenda grupeve të grave, por të shëndrohet në prioritet edhe në takimet e partisë dhe mbledhjet që mbahen. Gjithashtu, partitë politike duhet të punojnë në rritjen e demokracisë dhe barazisë së brendshme.⁸⁶

⁸⁴ Agolli, Ilirian, "Studiuesit: Pjesëmarrja e grave në vendim-marrje formale", Mars, 2013, Zëri i Amerikës.
<https://www.zeriamerikes.com/a/women-albania/1617890.html>

⁸⁵ Raport : "Dita globale e OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë-Me fokus në pjesëmarrjen e grave të Kosovës në politikë", UNMIK, Mars, 2018, Prishtinë, fq.13.

⁸⁶ Ibid.

Gratë në tërë Kosovën janë jashtëzakonisht pak të paraqitura në media, kjo për arsye se gratë nuk përkrahen dhe delegohen aq sa duhet nga shoqëria përreth, pastaj nga vendi i punës apo edhe nga subjekti politik që ato përfaqësojnë. Grave ende nuk u besohet diskutimi dhe debati për tema të cilat kanë aktualitet në vend dhe numërohen si madhore dhe të rëndësishme. Një tjetër mendim që adresohet nga vet gratë, sa i përket paraqitjes mediale, është edhe vullneti i vogël nga vet gratë për tu paraqitur, kjo e cila ndodh në shumicën e rasteve për shkak të gjuhës fyese që përdoret ndaj tyre në media si dhe mos-involvimin e tyre në çështje me rëndësi në komunën e tyre, por vetëm hapësira për diskutime me tema stereotipike gjinore.⁸⁷

Partitë politike që bëjnë mbështetjen e grave si kandidate politike mund të kenë edhe përfitime të ndryshme. Këto parti mund të rrisin bazën e simpatizantëve të tyre dhe mund të kenë përfitime zgjedhore nëse zbatojnë reformat për promovim dhe fuqizim të grave. Mbështetja ndaj grave dhe përkrahja e barazisë gjinore mund të rrisë interesimin për ato parti që ndoshta më herët mund të kenë pasur rënie, tërheqë anëtarë të rinj, mund të shtohet sasia e fondeve që merr partia dhe përgjithësisht fuqizimi i grave brenda partisë mund të sjellë si rezultat një parti politike më transparente dhe më demokratike.⁸⁸

Sa më shumë gra që do kenë guximin dhe kurajon të bëhen kandidate politike të një partie duhet të konsiderojnë veten si mbështetëse dhe pararendëse të të gjitha grave tjera që mund të vijnë pas tyre, sepse ato gra sot ua lehtësojnë rrugëtimin shumë grave të tjera nesër. Gratë që duan të ecin përpara në politikë mund të përfitojnë nga përvoja e grave të tjera që kanë marrë pjesë më parë në fushata zgjedhore. Besoj që duhet të kuptohet edhe fakti se sa më shumë gra në politikë nuk nënkupton aq më pak burra, prandaj edhe burrat nuk kanë pse të mos i mbështesin gratë dhe të përkrahin fuqizimin e tyre.

⁸⁷ Platformë - "Qeverisje Lokale që garanton barazi gjinore", Kosova Democratic Institute, 2017, fq.9.

⁸⁸ "Fuqizimi i grave për parti politike më të forta", UNDP, Shkurt, 2012, Prishtinë, fq.12.

II. Barrierat e gruas për inkadrim në politikën kosovare

Gratë në përgjithësi hasin barrierat të shumta në rrugën drejt politikës, mirëpo për gratë kosovare mund të thuhet se rruga e tyre për pjesëmarrje politike është mjaft e gjatë dhe me shumë barrierat. Rrjedhimisht, grave në Kosovë ju nevojitet vullneti i hekurt dhe ambicie shumë e fortë për t'u bërë ballë vështirësive dhe për të arritur aty ku dëshirojnë. Mentaliteti dhe roli tradicional i gruas janë barrierat kryesore që gruaja të arrijë synimet e saja në arenën politike. Kjo pasi që më parë është menduar se gruaja nuk ka kurrfarë roli të rëndësishëm në udhëheqjen e shtetit dhe rrallë herë do të ketë. Meqë, politika dhe shteti konsiderohen çështje që nuk i përkasin asaj dhe sa më pak të dinë gratë mbi ligjet aq më mirë do jetë, gruaja rrallë e ka gjetur mbështetjen dhe guximin për t'i dalë zot ëndërrave dhe qëllimeve të saja, mbi atë çfarë i intereson dhe ku e gjen ajo veten.⁸⁹ Injorimi i rolit të grave në politikë na privon nga të kuptuarit e një lloji tjetër të pushtetit dhe të qeverisjes dhe na kufizon mënyrën si kuptohet dhe mirëmbahet fuqia.⁹⁰

“Gratë zakonisht përshkruhen si krijesa më paqësore sesa burrat prej feministëve, qoftë nga ana biologjike, ashtu edhe kulturore, ose (çka më shumë të ngjarë) të të dy faktorëve së bashku. Këta feministë e vënë theksin te aftësitë e papërsëritshme të grave në ndihmesën e tyre si paqebërëse. Ata theksojnë rolin e grave si nëna/nëna të ardhshme. Për shkak të rolit të tillë kujdestar, gratë mësohet se janë më të prirura sesa burrat që t'i kundërvihen luftës dhe të gjejnë alternativa të ndryshme prej dhunës në zgjidhjen e konflikteve”.⁹¹

Shpesh ndaj grave vendosen barrierat të shumta sepse shumica mashkullore e dinë se gratë kërkojnë dhe sjellin ndryshime në agjendat politike, përkatësisht “gratë e zgjedhura nëpër

⁸⁹ Jansen, Sharon, “Debating women, politics and power in early modern Europe”, Palgrave Macmillan, New York, 2008, fq.112.

⁹⁰ Beckman, Peter & D'Amico, Francine, “Women, Gender, and World Politics”, Bergin & Carvey, 1994, Londër, fq.36.

⁹¹ Goldstein, Joshua, “Marëdhëniet Ndërkombëtare”, Shtëpia botuese Drita, Prishtinë, 2001, fq.136.

këshille lokale sjellin një grup të ri shqetësimesh në agjendat politike”.⁹² Për shembull, gratë janë të prirura të diskutojmë më tepër rreth politikave sociale, pastaj kujdesin shëndetësor, çështjet arsimore, kujdesin ndaj të moshuarëve, politika të ndryshme për fëmijë, lehtësime të ndryshme për gratë në fusha të ndryshme jetësore etj. Grave u vështirësohet depërtimi sepse burrat e dinë se gratë mund t’i përfaqësojnë më mirë gratë dhe po tu lihet rruga e lirë atëherë rrezikohet dominanca nga femrat. Mirëpo mos të harrojmë se gratë mund të përfaqësojnë denjësisht edhe burrat, prandaj përmes barrierave të ndryshme ndaj grave, burrat arrijnë të ruajnë dominancën historike të trashëguar.

"Burrrat dhe gratë ndryshojnë në qëndrimet ndaj vendimmarrjes: gratë janë më të përqëndruara në konsensus dhe balancë në komunikim dhe me orientim më demokratik, ndërsa burrat janë më të përqëndruar në konkurrencë dhe kanë një orientim më autokratik".⁹³ Pra në njëfarë mënyrë, gratë dhe burrat nuk i kanë të njëjtat mënyra dhe as pikësytme të qeverisjes. Gratë nuk synojnë konkurrencë dhe nuk shfaqin agresivitet, kurse burrat shfaqen më konkures dhe më pak kokëçarës në trajtimin e disa temave në shoqëri.

Megjithatë, John Stuart Mill që herët e ka vërejtur se barrierat ndaj grave janë të tepruara dhe aspak të arsyeshme. Siç e dimë të gjithë, gratë nuk mund të jenë perfekte në gjitha fushat por kjo nuk do të thotë se atyre duhet t’u ndalohet pjesëmarrja në ato fusha përkatëse. Mill shprehet se është shumë i tepërt nënshtrimi i një gjinie (në këtë rast gjinia femërore) nga gjinia tjetër dominuese, duhet të krijohet një sistem barazie ku të zhduket etiketimi si i paaftë ndaj një gjinie dhe privilegj dhe zotësi ndaj gjinisë tjetër. Gjithashtu, duhet të ndalohet dekurajimi i gruas se mund të bëjë një gjë por nuk mund të bëjë diçka tjetër, duhet që gruas t’i jipet kurajo për të provuar gjëra të reja, sepse asnjëherë nuk mund ta dimë sa të afta janë për një punë nëse nuk ua japim mundësinë ta provojnë. Autori merr shembull mbretëreshat angleze se si ia kanë dalë me udhëheqjen dhe patrioten nga Franca Zhan D’Ark. Pra, gratë mund të shkëlqejnë aty ku synojnë, nëse nuk bëhen vazhdimisht përpjekje për t’ua shuar shkëlqimin. Gjithashtu, duhet ndaluar së përmenduri natyrën si faktor që i ka limituar gratë dhe në njëfarë mënyre ua ka caktuar vendin ku ju përket, sepse sipas Mill kjo është shumë e pahijshme. Ai shprehet se e gjithë raca njerëzore varet nga përparimi i gruas në shoqëri, prandaj emancipimi i gruas jep shpresa për një shoqëri më të mirë, dhe një progres intelektual të burrave.⁹⁴

Një autor indian i quajtur Osho, në disa libra të tij ka trajtuar çështjen e burrave dhe grave. Sipas tij është shumë e dukshme që burrat dhe gratë nuk janë të barabartë me njëri tjetrin, sepse gratë bien pre e mashtrimeve të burrave dhe pastaj ata i shëndrojnë ato në qytetare të klasës së dytë. Mirëpo, nëse gruaja arrin të pavarësohet dhe të zhvillojë potencialin e saj atëherë ajo shëndrohet në një qenie të mrekullueshme. Meshkujt janë egoistë dhe kanë krijuar një shoqëri të tillë ku

⁹² Bratton & Ray, "Descriptive Representation, Policy Outcomes, and Municipal Day-Care Coverage in Norway", *American Journal of Political Science*, 2002, fq.435.

⁹³ Leijenaar, Monique, "Political Empowerment of women: The Netherlands and Other Countries", Martinus Nijhoff Publishers, Boston, 2004, fq. 82.

⁹⁴ Mill, John Stuart, "The Subjection of Women", Longmans, Londër, 1869.

rrallë ka vend për shfaqjen e cilësive unike të gruas. Prandaj, që femra të shfaqë ekzistencën e saj, ka filluar të imitojë mashkullin, të pijë duhan, të flasë me zë të lartë, të veshë pantollona, pra të tjetërsohet. Duhet thënë që kjo shoqëri duhet të ndalojë së prodhuari meshkuj të kategorisë së parë dhe meshkuj të kategorisë së dytë, por të pranojë si meshkujt ashtu edhe femrat të plotë me cilësitë dhe veçantitë karakterizuese.⁹⁵ Në librat e tij (“Femra” dhe “Libri i Urtësisë”) autori lutet që femrat mos ta humbin feminitetin e tyre, sepse është vlerë e shenjtë dhe qon në një mrekulli siç është mëmësia. “Mashkulli dhe femra janë dy tela të së njëjtës harpë, dhe, kur ata janë të ndarë, - vuajnë të dy. Për shkak të kësaj vuajtje dhe moskuptimit të arsyes së vërtetë, ata fillojnë të marrin hak ndaj njëri tjetrit”.⁹⁶ Ai shpjegon se nuk do jenë vetëm femrat që do tentojnë të duken si meshkuj por do ketë shumë meshkuj që do tentojnë të duken si femra, dhe kështu shoqëria do shëndrohet në një shoqëri të mërzitshme, pa ngjyra dhe pa diferenca.⁹⁷

II.1. Faktorët që ndikojnë në uljen e pjesëmarrjes së gruas në politikë

Tashmë dihet që pjesëmarrja politike e gruas në Kosovë është e ulët dhe lë shumë për të dëshiruar. Mirëpo, sigurisht që pas këtij fakti qëndrojnë një numër faktorësh që ndikojnë në uljen e pjesëmarrjes politike të gruas.

Faktorët ndikues janë si në vijim: faktori historik dhe kulturor, faktori psikologjik, faktori socio-ekonomik dhe faktori institucional.

- *Faktori historik dhe kulturor* e dimë që paraqet faktorin pothuajse më kryesor pasi historikisht dihen roli i burrit dhe roli i gruas në një shoqëri dhe të drejtat që secili gëzonte. Duke ekzistuar familja tradicionale gruaja asnjëherë nuk ka mundur të jetë në shërbim të vetës apo të ambicieve të saj, por gjithmonë në shërbim të familjes.

Ajo ka qenë grua, nënë dhe nuse e familjes, duke i kryer të gjitha punët e shtëpisë, duke gatuar dhe duke u kujdesur për të gjithë anëtarët e familjes. Pastaj, ky mentalitet veçse ishte bërë pjesë e kulturës dhe mbetet prezent edhe sot, ku thuhej se vendi i gruas është shtëpia dhe punët e saja janë brenda hapësirës shtëpiake. Në një shoqëri si kjo ku jetojmë, është problem që të inkurajohet dhe të vlerësohet pjesëmarrja e gruas në jetën politike. Mirëpo, sot dallohen zonat gjeografike që janë me mentalitet më të vjetër ndërsa fatmirësisht sot kemi një zbehje deri diku të faktorit historik dhe kulturor dhe po punohet për emancipimin e femrës dhe përfshirjen e saj në jetën politike edhe pse ende në fazën sipërfaqësore.⁹⁸

- *Faktori Psikologjik* ka të bëjë me faktin se gratë në shumicën e rasteve kanë mungesë vetëbesimi dhe kanë frikë të përfshihen në mjedise mashkullore, për faktin se mund të mos duken të përgatitura mjaftueshem ose nuk mund të përshtaten, pastaj kanë frikën e refuzimit dhe

⁹⁵ Osho, “Femra”, Shtëpia botuese ‘Fan Noli’, Tiranë, 2014.

⁹⁶ Ibid, fq.15.

⁹⁷ Ibid.

⁹⁸ “Women and Politics: Overcoming Barriers to Participating in leadership”, 2017, CESInstitute, Canada, fq.9.

në trurin e tyre e shohin veten që nuk mund t'ia dalin mbanë. Mendojnë se të gjithë i konceptojnë vetëm si nëna dhe shtëpiake dhe jo si karrieriste të suksesshme në të ardhmen.⁹⁹

Stereotipet janë barriera të dëmshme psikologjike, dhe fatkeqësisht të tilla kemi shumë në shoqërinë tonë. Janë të dëmshëm sepse kufizojnë gratë për të zhvilluar aftësitë e tyre personale, të ndjekin karrierën e tyre profesionale dhe të bëjnë zgjedhje për jetën e tyre dhe planet e jetës. Për shembull, është stereotipi se gratë nuk mund të kenë poste drejtuese sepse nuk kanë aftësi udhëheqëse. Kjo është barrierë e fortë psikologjike sepse i bën gratë të besojnë se është e vertetë që nuk mund t'ia dalin, dhe i dobëson para figurës së një mashkulli konkurent. Dhe këto barriera vazhdojnë dhe janë prezente kudo në shoqërinë tonë, gratë dëgjojnë stereotipe nga më të ndryshmet që janë dekurajuese dhe demoralizuese. Megjithatë, përkunder gjithë kësaj, sot kemi gra që përballen dhe e dëshmojnë të kundërtën e këtyre bindjeve jo të sakta. Dhe këto gra i thyjnë barrierat jo sepse shoqëria i mbështet por sepse besojnë në veten më shumë se në spekulimet e të tjerëve.

-Faktori socio-ekonomik nënkupton rrethanat shoqërore dhe ekonomike që shpesh shëndrohen në një barrierë për gratë në rrugën drejt pjesëmarrjes politike. Për shembull, shpesh joarsimimi i duhur i gruas, martesat e hershme, vendet rurale, familjet e mëdha, kushtet e pafavorshme, dominimi i politikës nga burrat por edhe besueshmëria e paktë në reformat e mundshme në politikë bëjnë që gruaja të privohet nga pjesëmarrja e saj në politikë.¹⁰⁰

-Faktori institucional janë politikat shtetërore, procedurat dhe situatat e ndryshme që shpesh shkojnë në disfavor të një grupi të caktuar të popullatës e në këtë rast në disfavor të grave. Për shembull, këtu përfshihen shpesh politikat që përmbajnë në vete diskriminim gjinor dhe nuk ua mundësojnë grave depërtimin deri tek pozita e synuar, duke vendosur kërkesa dhe kushte që ndoshta gruaja me jetesën dhe standardin aktual nuk mund t'i plotësojë.¹⁰¹

Përveq këtyre faktorëve të përmendur më lartë duhet shtuar se duke e vrojtuar dhe analizuar mjedisin politik kosovar mund të thuhet se agresiviteti dhe banalizmi i tepërt në politikën kosovare bën që mos të jetë një mjedis shumë i përshtatshëm për femrat. Prandaj, gratë nuk e shohin të përshtatshme të përfshihen në skenën politike sepse nuk duan të jenë objekt i sharjeve ose i skandaleve ndoshta edhe të montuara por që mund të jenë një njollë për emrin dhe veprimtarinë e tyre.

Pastaj, edhe diçka tjetër është më se e dukshme, fakti se femrat nuk e mbështesin njëra tjetrën ashtu siç bëjnë burrat me njëri tjetrin. Pra, një grua nëse vendos të inkuadrohet në skenën politike nuk e has mbështetjen e grave shumicë. Madje vërehet fenomeni se gratë që kanë arritur ndonjë post më të lartë brenda partisë nganjëherë edhe e pengojnë aktivitetin e grave tjera anëtare. Një shkrimtare shqiptare Flutura Açka flet për këtë “egoizmin femëror” dhe shprehet kështu: “Po të jetë fjala për meshkujt, ata dinë si ta mbajnë njëri-tjetrin, gjejnë gjithnjë hapësira, edhe kur

⁹⁹ Ibid, fq.10.

¹⁰⁰ “Women and Politics: Overcoming Barriers to Participating in leadership”, 2017, CESInstitute, Canada, fq.10,11.

¹⁰¹ Shames, Shauna, “Barriers and Solutions to Increasing Women’s Political Power”, 2015.

https://scholars.org/sites/scholars/files/shauna_shames_-_barriers_and_solutions.pdf

urrehen. Me femrat kjo nuk ndodh. Mjafton të vëresh në një mjedis kur duhet të zgjidhet të drejtojë një femër, janë femrat ato që të parat nuk e votojnë. Janë të gatshme t'i japin kreditet një mashkulli, se njëres prej tyre. Mjaft të shohësh luftën në politikë, brenda partive, femrat që janë në majë zor se i japin frymëmarrje ndonjë tjetre aty afër. A ka ndonjë zë femre që dëgjohet me të vërtetë, po qe se komandon ndonjëra prej nesh? Zor të ndodhë”.¹⁰² Gratë duhet të kuptojnë një herë e mirë se vetëm nuk mund t'ia dalin, janë një pikë e vogël uji, mirëpo së bashku janë i gjithë oqeani. Maya Angelou, një autore e njohur, shprehet se “sa herë një grua qëndron dhe ngrit zërin për veten e saj, ajo në fakt e ka bërë këtë për të gjitha gratë”. Kur gratë mbështesin njëra tjetrën padyshim që gjëra të mrekullueshme ndodhin.

II.2. Pengesat në procesin e rekrutimit të gruas si kandidate politike

Ne sot edhe pse jo në raste aq të shpeshta, mund ta shohim një grua të kandidojë për një post të caktuar politik në Kosovë. Mirëpo, jo të gjithë e mendojmë rrugën e gjatë dhe të vështirë që ka kaluar ajo grua që me nder e me meritë të arrijë kandidimin për pozitën e synuar. Kjo sepse siç është shpjeguar edhe më herët, duhen kaluar shumë barriera, fillimisht duke nisur nga vetja e pastaj duke vazhduar te rrethi, që të arrihet pjesëmarrja dhe inkuadrimi në jetën politike.

Pengesa e parë në rekrutimin e gruas si kandidate politike është vështirësia e futjes në listë. Mungesa e gatishmërisë dhe mbështetjes së partive për të krijuar hapësirë më të madhe për gratë kandidate në listat e partive është pengesa më e madhe për gratë që synojnë të kandidojnë për pozita. Qasjet e partive për përfshirjen e grave në listat e kandidatëve partiakë ndryshojnë por nuk ka shumë shembuj ku partitë i kalojnë kërkesat ligjore të kuotës gjinore. Për gratë ekzistojnë kufizime kur bëhet fjalë për të kandiduar për t'u futur në listën e partisë, kjo sepse përkrahen më shumë kandidatët meshkuj, sidomos ata që janë aty prej fillimit ose për një kohë më të gjatë.¹⁰³ Sigurisht nëpër parti gratë nuk refuzohen ose dekurajohen haptazi por u jepet një mundësi të llojëvetë për kandidaturën. Pasi që degët e partive në Kosovë rrallë bëjnë emërimin e grave, mundësia e gruas për t'u futur në listën e partisë shpesh varet nga disa faktorë si nga mbështetja e udhëheqësve të lartë të partisë, nga profili i tyre publik, financat dhe mbështetja financiare që mund të sigurojnë dhe aftësitë për lidërsip partiak.¹⁰⁴

Burrat e kanë më të lehtë depërtimin si kandidat të futen jo vetëm në listë, por të depërtojnë edhe te presidenca e partisë ose poste të tjera të rëndësishme. Shumica e partive politike në Kosovë nuk i kanë freskuar procedurat e tyre të emërimit apo nuk u përmbahen procedurave zyrtare në

¹⁰² Sula, Mirela, “A diskriminohen gratë nga vetë gratë”, 2012.

<https://www.albanianwoman.com/a-diskriminohen-grate-nga-vete-grate/>

¹⁰³ Kosovë: Tejkallimi i pengesave për pjesëmarrjen e grave në politike, 2015, Instituti Kombëtar Demokratik, Prishtinë, fq.12.

¹⁰⁴ Ibid.

praktikë. Pastaj është problem edhe mungesa e transparencës dhe dominanca e një numri të personave që i zgjedhin vetë ose ndikojnë shumë në kandidatët që do futen në lista.¹⁰⁵

Duhet që brenda partisë të mbizotërojë meritokracia, transparenca dhe më e rëndësishmja të jenë politikat e barazisë gjinore, ku secili anëtar i partisë përmes angazhimit dhe punës të ketë mundësi ta tregojë vetveten, dhe përmes trajnimeve të shumta edhe burrat edhe gratë në parti përmes meritokracisë të fitojnë detyrat dhe postet që i synojnë. Fatkeqësisht, në partitë politike në Kosovë ndodh që edhe kur gratë futen në lista për shkakun e kuotave, kjo nuk bëhet për shkakun e meritave ose kontributit që shfaqin. Kjo vjen si rrjedhojë e ndërlidhjeve që ato gra mund të kenë me udhëheqësit e partisë.

Pengesa e rradhës në procesin e rekrutimit të gruas si kandidate politike është ngurimi për të kandiduar. Një pjesë e madhe e grave ngurojnë për të kandiduar për poste politike sepse e shohin politikën si një rrugë të gjatë dhe të vështirë, ku duhen sakrifica të shumta për të arritur synimet. Mirëpo, arsye tjetër për ngurim është fakti se gratë e shohin politikën kryesisht si fushë burrash dhe të dominuar fuqishëm nga ata. Një anketë e UNDP më 2014 tregon se: “vetëm 8 për qind të grave janë përfshirë në parti politike, kundrejt 22 për qind të meshkujve. Gati një e treta e grave në popullatën e përgjithshme besojnë se gratë zbrapsen nga burrat në partitë politike, dhe se diskriminimi është një shkak i madh i përfaqësimit të ulët të grave në pozita. Gratë e perceptojnë arenën politike si të njëanshme ndaj tyre”.¹⁰⁶ Një pjesë ngurojnë të marrin pjesë në politikë sepse e mendojnë ndikimin që mund të kishte politika në familje ose në jetën e tyre private, se çfarë çrregullimesh eventuale mund të sillte dhe si përfundim zgjedhin mirëqënien e familjes kundrejt karrierës politike që mund të kishin.

Faktori i rradhës që ndikon në ngurimin e grave drejt politikës është faktori i medias. Mediat në Kosovë kanë liri goxha të madhe dhe shpesh nuk kanë kurrfarë kontrolli mbi llojin e çështjeve që trajtojnë dhe në mënyrën se si i artikulojnë informacionet. Shpesh trajtojnë çështje nga më banalet, gënjejnë haptas dhe shprëndajnë informacione të pavërteta. Prandaj, media të tilla nuk do nguronin fare që edhe gratë politike t'i shëndronin në kryefjalë të skandaleve apo sjelljeve jo-etike. Dhe për një grua nuk do ishte e lehtë kostoja që do duhej të paguante për përfshirjen ose veprimtarinë e saj politike. Gratë ngurojnë të kandidojnë edhe për faktin se nganjëherë u mungon vetëbesimi dhe mendojnë se nuk mund t'ia dalin në një mjedis të egër dhe kaotik politik, por shpesh u mungon edhe mbështetja.

Ndryshimi i rrethanave dhe inkurajimi i grave drejt politikës bëhet përmes vendimeve strategjike, përmes perceptimit ndryshe të rolit të gruas dhe konceptimit të përbashkët të vlerave dhe besimeve kolektive. Nuk duhet që politika ti përcaktojë vlerat e shoqërisë por ato duhet ta formësojnë politikën.¹⁰⁷

¹⁰⁵ Ibid.

¹⁰⁶ Kosovë: Tejkalmi i pengesave për pjesëmarrjen e grave në politikë, 2015, Instituti Kombëtar Demokratik, Prishtinë, fq.13.

¹⁰⁷ Banaszak, An Lee, “Why movements succeed or fail- opportunity, culture and the struggle for the woman suffrage”, Princeton, New Jersey, 1996, fq.31.

Pengesat kryesore në pjesëmarrjen e grave në proceset e rekrutimit janë si në vazhdim: “ekzistimi i vlerave thellësisht të rrënjosura patriarkale dhe i stereotipeve gjinore për rolin dhe pozitën e gruas në shoqëri; mungesa e vullnetit politik brenda partive politike për promovimin e kandidatëve femra, posaçërisht në rolet udhëheqëse; mungesa e qasjes së grave në resurse dhe media gjatë fushatave të tyre dhe prania e diskriminimit gjinor dhe stereotipeve në media”.¹⁰⁸ Kultura mbizotëruese e dominimit të meshkujve jo gjithmonë ua mundëson partive politike që jenë të hapura dhe inkurajuese për kandidatet gra. Udhëheqësit e partive politike nuk i perceptojnë gratë si “asete”, por thjeshtë si “kuota”, dhe pa vullnet politik për ndryshimin e kësaj mendësie, realiteti nuk do të ndryshohet.¹⁰⁹

Në Kosovë gratë prej fëmijërisë janë rritur me mendimin se nuk duhet të jenë shumë konkuresuese ose që duhet të jenë sa më pak kundërshtuese ndaj një burri. Janë ushqyer me faktin se kurrë nuk mund t’ia dalin një pune në krye të vetme siç mund ta bëjë një burrë. Vetë njerëzit për një post të caktuar gjithmonë të parin të përshtatshëm e shohin burrin. Një kandidat mashkull e përkrahin edhe gratë edhe burrat kurse një kandidatë femër gjithmonë e kryqëzojnë me opinione nga më të ndryshmet dhe ajo duhet të dëshmojë dhe ta arsyetojë veten tek të tjerët përderisa një mashkull asnjëherë nuk ka nevojë. Kjo kulturë e prapambetur nuk do ndryshojë derisa gratë së bashku të marrin iniciativë ta ndryshojnë. Dhe kjo arrihet kur shtohet numri i grave të suksesshme në pozita të rëndësishme.¹¹⁰

II.3. Sfidat e gruas gjatë një procesi zgjedhor apo fushate politike

Sfidat më të dukshme të gruas gjatë një procesi zgjedhor apo një fushate politike në Kosovë janë: profili i ulët publik, portretizimet gjinore, mungesa e mundësive të rrjetëzimit, mungesa e ndihmës financiare prej partive dhe konkurenca e brendshme partiake.

Profili i ulët publik- në një fushatë zgjedhore është shumë e rëndësishme që kandidati të rrijë afër popullatës në mënyra të ndryshme. Kandidati duhet të organizojë jo vetëm fushata dhe tubime për të shpalosur planet e tij por duhet edhe të paraqitet publikisht përmes medias. Duhet që me anë të reklamave të paraqitet sa më mirë, të flasë për planprogramin dhe të mbajë një fjalim të shkurtër mbresëlënës. Por, problemi i profileve joadekuate publike është i përbërë nga mungesa e mundësive të mediave për gratë kandidatë. Partitë politike vazhdojnë të dominohen nga meshkujt dhe mediat japin mbulim shumë më të gjerë për kandidatët meshkuj. Poashtu, edhe në debatet televizive që zhvillohen gjatë kohës së fushatës, gratë janë shumë pak pjesëmarrëse. Gjithmonë është tendenca të dërgohen meshkuj përfaqësues sepse do jenë më të zotë në debat dhe ka

¹⁰⁸ Raport përmbledhës: “Dita globale e OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë” me fokus në pjesëmarrjen e grave të Kosovës në politikë, UNMIK, 2018, Prishtinë, fq.9.

¹⁰⁹ Ibid.

¹¹⁰ Driedger, Myrna, “Challenges for women in Politics”, Canadian Parliament review, 2013, fq.16.

hezitim të dukshëm për përfaqësimin femëror.¹¹¹ Fatmirësisht sot përmes rrjeteve sociale gruaja e ka më të lehtë të ngrisë sado pak profilin e saj publik. Mund të bashkëbisedojë online me qytetarët, mund të thotë fjalën e saj pa qenë e varur nga minutazhi medial, të lexojë kërkesat dhe përshtypjet e qytetarëve dhe mbi të gjitha votuesit do të dinë se e kanë edhe një kandidate që ndoshta mund të mos e ketë përkrahjen e plotë të partisë ose mediave por mund të arrijë të fitojë atë të votuesve.

Portretizimet gjinore- Gratë që kandidojnë për poste politike vazhdimisht ndeshen me paragjykime me bazë gjinore, të cilat pengojnë karrierën e tyre të lirë dhe dëmtojnë shanset e barabarta për konkurim. Shanset e grave për karrierë të lartë drejtuese janë të kufizuara për shkak se ekziston një perceptim i brendshëm në partitë politike se lufta e ashpër politike kërkon udhëheqës meshkuj dhe se vetëm burrat mund ta përballojnë sfidat konkurruese me të cilat ndeshen partitë politike në zgjedhjet lokale e parlamentare.¹¹²

Gjithmonë ekziston mendimi i ngulitur se gruaja nuk duhet të bredhi shumë lart e poshtë në promovim të fushatës së saj, ose nuk duhet të flasë shumë, të frenohet në debate televizive, të bëjë kujdes me fjalet që përdorë dhe mos të ngrisë zërin etj. Mirëpo, politikani dhe ambasadori suedez Johan Ndisi mbi këtë çështje shprehet kështu: “Gratë duhet të jenë në politikë sepse përfaqësojnë gjysmën e popullsisë dhe sepse vendet publike duhet të merren në bazë të meritës dhe jo të gjinisë. Ndërkohë, unë nuk besoj se kjo automatikisht do të thotë se një numër më i madh i grave në politikë do ta bënë politikën më pak konfliktuale, pasi kjo do të supozonte që gratë sillen në një mënyrë të caktuar në bazë të portretizimeve gjinore”.¹¹³

Mungesa e mundësive të rrjetëzimit - gratë nuk kanë mundësi të qasjes në rrjete të cilat burrat në mënyrë rutinore i përdorin për të avancuar profilet e tyre. Për shembull, është shumë e vështirë për gratë të lidhen me votuesit e zonave rurale, kështu që ato në momentin që nuk kanë kontakt me ata njerëz dihet që nuk do e fitojnë mbështetjen e kërkuar. Poashtu, duhet theksuar që edhe vetë obligimet e grave jashtë kuadrit të punës, si ato të shtëpisë dhe kujdesjes për familjen ua limitojnë kohën që ndoshta do e shpenzonin për të fituar mbështetjen e votuesve. Pastaj, mjediset në të cilat diskursi politik lokal është tradicional, si odat në familjet tradicionale shqiptare, janë në mënyrë tipike të zotuar nga burrat dhe janë pak të arritshme për gratë. Vendimet se cilët kandidat do të mbështesin partitë shpesh janë bërë në mjedise të tilla, përsëri duke i dëmtuar gratë kandidate, duke ua pamundësuar pjesëmarrjen.¹¹⁴ Prandaj, gratë ende nuk e kanë mundësinë e rrjetëzimit ashtu siç e kanë burrat.

¹¹¹ Kosovë: Tejkalmi i pengesave për pjesëmarrjen e grave në politike, 2015, Instituti Kombëtar Demokratik, Prishtinë, fq.14.

¹¹² “Standardet e përfaqësimit në partitë politike”, Instituti i Studimeve Politike, Tiranë, 2017, fq.17.

¹¹³ Ibid, fq.80.

¹¹⁴ Kosovë: Tejkalmi i pengesave për pjesëmarrjen e grave në politike, 2015, Instituti Kombëtar Demokratik, Prishtinë, fq.16.

Mungesa e ndihmës financiare prej partive – zakonisht kandidatet gra nuk i kanë burimet materiale të mjaftueshme për të filluar një fushatë politike. Mirëpo, shumica e partive deklarojnë se nuk janë në gjendje ti ndihmojnë financiarisht këto gra por as tu mundësojnë pjesëmarrjen në trajnime të ndryshme. Kandidatët meshkuj shpesh kanë qasje më të madhe në burimet partiake dhe përfitojnë nga fonde të ndryshme shkakui rrjeteve të bizneseve të cilave mund t’u përkasin. Poashtu, kandidatët meshkuj kanë kontakte më të zgjeruara me njerëz dhe lidhjet familjare ose shoqërore që mund të kenë u mundësojnë avantazhin.¹¹⁵

Konkurenca e brendshme partiake – është një sfidë e theksuar për gratë gjatë një fushate elektorale mirëpo njëkohësisht është dukuri e pamohueshme dhe ekzistente në çdo parti jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon e më gjërë. Kjo konkurrencë është në disavantazh të grave për faktin se janë të pakta në numër dhe janë shumë më pak të përkrahura sesa kandidatët meshkuj.¹¹⁶

Mirëpo, shtohet pyetja se ku gratë mund të jenë më shumë të promovuara dhe të mbështetura, në një parti të centralizuar apo të decentralizuar? Në një parti shumë të centralizuar kryetarët kanë kontroll për të krijuar hapësira për pjesëmarrjen e grave - kur ata duan ta bëjnë këtë. Mund të pritët që gratë të përfaqësohen më mirë aty ku liderët e partive munden të bëjnë përpjekje efektive për të promovuar gratë kandidate nëpërmjet përdorimit të politikave të veçanta të partisë. Një organizim partiak i centralizuar mund të jetë më i përgjegjshëm për përfshirjen e kandidateve femra sepse nëse nuk plotësohen kërkesat kërkohet llogari nga kryetari i partisë. Në një sistem më të decentralizuar, çdo përfaqësim lokal duhet të jetë individualisht nën presion për të mbështetur gratë.¹¹⁷ Dhe fakti që secili punon individualisht nënkupton që mund të ketë rezultate të ndryshme që jo gjithmonë mund të jenë të kënaqshme.

¹¹⁵ Ibid.

¹¹⁶ Kosovë: Tejkalmi i pengesave për pjesëmarrjen e grave në politike, 2015, Instituti Kombëtar Demokratik, Prishtinë, fq.17.

¹¹⁷ Matland, Richard & Studlar, Donley, “The Contagion of Women Candidates in Single-Member District and Proportional Representation Electoral Systems: Canada and Norway”, Journal of Politics, 1996, Vol.58, fq.707.

III. Kuotat gjinore dhe pjesëmarrja e gruas në nivelin qendror dhe lokal politik

III.1. Kuota gjinore në Kosovë dhe rëndësia e saj

Kuota gjinore paraqet një ndër temat më të përfolura dhe më të diskutuara kur bëhet fjalë për gruan dhe pjesëmarrjen e saj politike në Kosovë. Dihet që rëndësia e saj është e madhe për avancimin e gruas në politikë, mirëpo ekzistojnë edhe kundërshtime nga më të ndryshmet, sepse në një farë mënyrë kjo kuotë konsiderohet si një favor ndaj grave përkundër meritave dhe kontributit që ato japin në politikë dhe në shoqëri.

Në vitin 2001, në zgjedhjet e para parlamentare të mbajtura nga Bashkësia Ndërkombëtare ishte imponuar kuota prej 33 për qind për përfaqësimin e grave në Parlament. Kurse në zgjedhjet e mbajtura në vitin 2004, ishte formuar Ligji i parë për Barazi Gjinore që kishte sanksionuar kuotën prej 40 për qind të përfaqësimit të grave në gjitha nivelet e pushtetit. Ndërsa, kodi zgjedhor i miratuar në vitin 2008 kishte sanksionuar kuotën prej 30 % të përfaqësimit të grave në Parlament.

Shumica pajtohen se kuota gjinore ka ndihmuar në rritjen e përfaqësimit të grave në Parlament dhe në pozita vendimmarrëse. “Shumica e grave dhe burrave pajtohen se Kosova nuk do të kishte zgjedhur 39 gra deputete në vitin 2014 pa kuota. Në secilat zgjedhje në vazhdim, më shumë gra janë duke hyrë në parlament në bazë të numrit të votave preferenciale të marra personalisht, se sa nëpërmjet ndarjes së vendeve përmes kuotave. Në zgjedhjet parlamentare të 2014-ës, 20 për qind e pesë (5) ose dhjetë (10) kandidatëve më të votuar në listat e shumicës së

partive ishin gra, pavarësisht nga fakti se ato garonin kundër kandidatëve të profileve të larta politike. Prandaj, shumë pajtohen se do ishte tepër e pakuptimtë nënvlerësimi ose shfuqizimi i kuotes gjinore sepse do duhen edhe disa zgjedhje më shumë para se Kosova të mund të arrijë një përfaqësim të barabartë të grave pa pasur nevojë për kuota”.¹¹⁸

Për shkak se numri i grave në politikë po rritet me ritme të ngadalta, janë shtuar nevojat për metoda efikase për të adresuar problemin e nënpërfaqësimit të grave. Kuotat gjinore zgjedhore janë një mekanizëm i futur në më shumë se 100 vende të botës, prandaj edhe në Kosovë janë parë dhe ende shihen si të domosdoshme. Kuotat gjinore zgjedhore marrin dy forma kryesore: kuotat ligjore dhe kuotat e partive. Kuotat e legjislativit (të quajtura edhe kuota ligjore) zbatohen përmes reformimit të ligjeve zgjedhore dhe kërkojnë që të gjitha partitë të emërojnë një pjesë të caktuar të kandidateve femra. Kuotat e partive (që quhen edhe kuotat e partive vullnetare) janë zotimet e bëra nga partitë politike individuale për të përfshirë një përqindje të caktuar të anëtareve të tyre gra midis kandidatëve të tyre për zgjedhje. Kjo bëhet përmes programeve të partisë, statuteve dhe rregullave shtesë të partisë.¹¹⁹

Elitat politike mund të shprehin përkushtim ndaj kuotave në mënyrë që të duken moderne dhe progresive në sytë e bashkësisë ndërkombëtare.¹²⁰ Inkurajimi gjinor në jetën politike në Kosovë është kërkuar tash e shumë vite me rradhë nga Bashkimi Evropian dhe barazia gjinore konsiderohet si një kusht që duhet plotësuar me patjetër. Prandaj, si partitë ashtu edhe institucionet në Kosovë e kanë më të lehtë punën me ndihmën e kuotave të vendosura.

Kuota e përfaqësimit të grave prej 30% obligon partitë politike që në listat e tyre të kandidatëve për Kuvend të Kosovës të aplikohet që 30% e numrit të përgjithshëm të kandidatëve të jenë gra. Disa vende aplikojnë kuotat vetëm në listat e partive politike dhe jo në përzgjedhjen e tyre për Parlament, ngase kjo u lihet vullnetit të votuesve. Në Kosovë, kuota detyruese vlen si për listat partiake zgjedhore, ashtu edhe për përfaqësimin në Kuvend. Duhet kujtuar se në dy palë zgjedhjet e para të mbajtura në Kosovë, listat zgjedhore kanë qenë të mbyllura, çka bënte që të votohej vetëm partia, dhe pastaj votat e marra ndaheshin mes kandidatëve të partisë. Kjo e ulte mundësinë që gratë të merrnin shumë vota, dhe rrjedhimisht nuk merrnin edhe shumë vende. Por nga viti 2007, me aplikimin e listave të hapura, është e mundur të kalkulohet saktësisht se sa gra janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës shkaku i kuotave. Të dhënat tregojnë se kuotat kanë ndikuar që gratë të votohen gjithnjë e më shumë në zgjedhjet parlamentare. Në legjislaturën e tretë të dalë pas zgjedhjeve të vitit 2007, nga 37 gra sa përfaqësoheshin në Kuvendin e Kosovës, 29.7% e tyre kishin fituar ulëset e tyre pa ndihmën e kuotave; në legjislaturën e katërt, të dalë

¹¹⁸ “Kosovë: Tejkallimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë”, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), 2014, fq.11.

¹¹⁹ Ballington, Julia & Binda, Francesca, “The Implementation of Quotas: European Experiences”, Idea, 2005, Stokholm.

¹²⁰ Htun, Mala & Jones, Mark, “Engendering the Right to Participate in Decision-making: Electoral Quotas and Women's Leadership in Latin America in Gender and the Politics of Rights and Democracy in Latin America, ed. N. Craske and M. Molyneux, Londër, Palgrave, fq.200.

nga zgjedhjet e dhjetorit 2010, nga 40 gra në Kuvendin e Kosovës, 35% e tyre ishin pjesë e Kuvendit pa ndihmën e kuotës; kurse në legjislaturën e pestë, e dalë nga zgjedhjet e qershorit 2014, nga 39 gra deputete, 36% e tyre ishin pjesë e Kuvendit pa ndihmën e kuotave.¹²¹

Në një raport të marsit 2018 mbi pjesëmarrjen e grave kosovare në politikë, shkruhen opinionet e disa grave kosovare të aktivizuara në politikë, lidhur me kuoten gjinore dhe rëndësinë e saj. Për shembull, znj. Aida Derguti me detyrë zëvendëskryetare e Kuvendit të Kosovës, mendon se ka rëndësi shumë të madhe për një grua që synon pjesëmarrjen në politikë, që me kalimin e kohës ta zgjerojë rrjetin e kontakteve dhe të rritë takimet e drejtëpërdrejta me popullatën. Ajo shprehet se kjo është një formulë që ka funksionuar për karrierën e saj politike. Ndërsa znj. Kusari- Lila, ish ministre dhe kryetare komune, thotë që nuk ka lehtësime për gratë, sepse për to gjithmonë ekzistojnë standardet e dyfishta dhe gjithçka që marrin ato e meritojnë. Kurse znj. Valdete Daka – kryetare e Komisionit Qëndror Zgjedhor deklaroi se futja e kuotave ua ka mundësuar grave që të kenë ulëse në Kuvendin e Kosovës që përndryshe do të ishin të paimagjinueshme. Ajo theksoi nevojën për ndryshimin e Ligjit për barazi gjinore për ta bërë të obligueshme që të gjitha listat e kandidatëve të përfshijnë 50 për qind gra. Ndërsa një deklaram të drejtëpërdrejtë kishte bërë edhe deputetja Duda Balje, e cila ishte shumë pro kuotave sepse siç deklaroi edhe ajo vetë është zgjedhur për herë të parë falë kuotës dhe aktualisht është deputete në mandatin e saj të tretë si rezultat i angazhimit të saj me komunitetin.¹²²

Pra, vitet e fundit, kuotat zgjedhore janë bërë një politikë mjaft e përhapur për të sjellë më shumë gra në politikë. Kuotat janë një mënyrë për të garantuar që pjesëtarët e një grupi të elektoratit, si gratë, të përfshihen në një nivel të paracaktuar në institucionet përfaqësuese, qoftë si delegate, kandidate apo zyrtare të zgjedhura.¹²³

Por, siç ndodh rëndom në vendet demokratike ku gjithçka është e diskutueshme, ashtu edhe rëndësia e kuotës diskutohet mjaft. Përderisa gratë vetë e përkrahen kuoten sepse e kanë si një lloj ndihmese për të depërtuar aty ku ato synojnë, ka mendime se këto kuota po përdoren kundër avancimit të grave. Anëtarët meshkuj të partive që garojnë kundër grave në votim preferencial u thonë përkrahësve se gratë kandidate do t'i fitojnë postet automatikisht përmes kërkesës së kuotës, kështu që nuk ka nevojë të “hidhen votat kot” duke dhënë votat preferenciale për kandidatet gra. Kjo parandalon më shumë gra për t'u zgjedhur dhe mund të shtrembërojë procesin zgjedhor me nën-përfaqësimin e kandidateve gra krahasuar me mbështetjen që janë në gjendje ta mbledhin.¹²⁴

¹²¹ “Përfaqësimi i grave në bordet e ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura”, USAID, Prishtinë, Qershor, 2017, fq.14.

¹²² Raport “Dita globale e OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë- Me fokus në pjesëmarrjen e grave të Kosovës në politikë”, UNMIK, Mars, 2018, Prishtinë, fq.10,11.

¹²³ “Fuqizimi i grave për parti politike më të forta”, UNDP, Shkurt, 2012, Prishtinë, fq.4.

¹²⁴ Kosovë: “Tejkalimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë”, Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), Shkurt, 2015, Prishtinë, fq.11.

Gjithashtu edhe gratë e zgjedhura, në mënyrë që mos të ndihen inferiore ose pasive në postet që marrin, tentojnë të tregojnë numrin e votave ose të tregojnë nëpër mënyra të ndryshme se nuk kanë përfituar shumë nga kuota ose ia kanë dalë mbanë me forcat e veta. Kjo është gabim sepse pa marrë parasysh më ose pa kuotë secila grua që mundohet dhe punon vlen të respektohet, ndaj dhe ky marginalizimi është shumë i pavend. Prandaj, është e rëndësishme që strukturat e grave brenda partive, gratë deputete dhe partitë politike të ndalen së bëri dallime midis grave të zgjedhura përmes mekanizmave të ndryshëm. Përfundimisht, besoj që në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që kuotat të jenë vendimtare për ngritjen e gruas në politikë. Është i padiskutueshëm fakti që janë një ndihmesë mirëpo gratë mund t'ia dalin edhe me meritokraci e duke u treguar konkurente, mjafton të mos u vendosen barrierat të padrejta gjatë rrugës drejt politikës, dhe të mos kenë standarde të dyfishta vlerësimi vetëm për faktin që janë femra.

Nëse një femër anëtare e Kuvendit respektivisht deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës jep dorëheqje atëherë ajo zëvendësohet me një femër tjetër që ka më së shumti vota pas saj. Kjo sepse duhet bërë plotësimi i kërkesës së kuotës për përfaqësim. Ligjet për kuotat gjinore janë ligje fundamentale dhe kanë bazë kushtetuese, kështu që çfarëdo lloj zëvendësimesh dhe ndryshimesh që ndodhin prapë në fund ruhet 30% i kuotës gjinore për femrat. Pasi që një ulëse të mbetet e

zbrazët, Kryetari i Kuvendit i bën kërkesë me shkrim Presidentit për mbushjen e ulëses së zbrazët. Një kërkesë e tillë duhet të përfshijë edhe sqarimin se pse u lirua kjo ulëse.¹²⁵ Poashtu, zëvendësimi nuk bëhet vetëm me dorëheqje por edhe në rast vdekjeje, dënimi të anëtarit për vepër penale, dështimi të marrjes pjesë në seancat e Kuvendit për gjashtë muaj apo në rast paaftësie mendore ose fizike të deputetit.¹²⁶

III.2. Pjesëmarrja e gruas në Kuvend

Në një nga kapitujt e kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësojmë për anëtarësim në Bashkim Evropian është sigurimi i mundësive të barabarta për burrat dhe gratë. Por siç është theksuar disa herë brenda punimit, angazhimi i gruas në politikë nuk duhet parë si kusht për integrim në Bashkimin Evropian por duhet konsideruar si një e drejtë njerëzore. Mirëpo, është e vështirë për gratë të fuqizohen në politikën vendimmarrëse pasi ato pengohen nga kufizimet e shumta partiake.

Pjesëmarrja e grave në Kuvendin e Kosovës është e garantuar me Ligjin për Zgjedhje të Përgjithshme. Në Nenin 27 të këtij ligji parashihet që lista e kandidatëve të secilit subjekt politik të ketë së paku 30 për qind të kandidateve gra: “Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë. Kjo dispozitë nuk aplikohet te listat e përbëra nga

¹²⁵ “Projektligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës”, Neni 109/ Zëvendësimi i anëtarëve të Kuvendit, Prishtinë, fq.125.

¹²⁶ Ibid.

një apo dy kandidatë.”¹²⁷ Skeleti i këtij neni qëndron tek fakti se nëse listat zgjedhore llogariten si lista treshe atëherë një nga ata kandidatë duhet të jetë femër, ose nëse minimumi i kandidatëve është tre e sipër, aplikohet kuota gjinore prej 30%. Dhe si rrjedhojë dihet se kjo nuk vlen nëse janë vetëm dy kandidatë në listë.

Gratë vazhdojnë të mbeten të nënpërfaqësuar në pozitat drejtuese në Kuvend. Shumë mendojnë se mungesa e gruas në pozita të tilla politike është si rezultat i kualifikimit të ulët të gratë, mungesës së talentit, mungesës së ambicieve politike dhe të vetëbesimit për të marrë vendime politike. Mirëpo, duhet theksuar se ka mjaft gra të përgatitura në këtë pikëpamje, që i hedhin poshtë këto mendime dhe janë shumë të zonjat në shkollim, politikë dhe lidhësi.

Sot gratë deputete në Kuvendin e Kosovës e kanë grupin e tyre joformal të Deputeteve i cili është formuar në korrik të vitit 2005. Ky Grup përbëhet nga të gjitha gratë deputete në Kuvendin e Kosovës dhe udhëhiqet nga Bordi i grupit që përbëhet nga një deputete prej secilit grup parlamentar, dhe kryesohet nga deputetja Dr. Flora Brovina, njëherit edhe deputetja më e vjetër në moshë. Objektivat e këtij grupi janë: Fuqizimi i gruas në politikë dhe vendimmarrje (pasi dihet sa është e nevojshme që gratë në politikë të kenë mbështetjen e grave të tjera që kanë përvojë); Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore si dhe të gjitha ligjeve të tjera që kanë të bëjnë me përparimin e pozitës së gruas në shoqëri; Promovimi i mundësive të barabarta të gruas, në çdo sferë të jetës, si në politikë, edukim, kulturë, shëndetësi, ekonomi, arsim etj; Zgjerimi i bashkëpunimit në mes të grave në politikë dhe shoqërisë civile; Bashkëpunimi në mes të grave deputete të parlamenteve regjionale (pasi jo vetëm mundësohet mbështetje e ndërsjellë por edhe shkëmbim i përvojave politike); Monitorimi i implementimit të Objektiveve Zhvillimore të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara.¹²⁸

Ky grup joformal prej fillimit ka pasur për qëllim organizimin e aktiviteteve me qëllim të ngritjes së vetëdijes, kontaktit me qytetarë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë. Për shembull, disa nga këto aktivitete numërohen: Nisma për hartimin e Ligjit për Barazi Gjinore; Vizita në shkolla të mesme dhe takime me qytetarë; Nisma për ndryshimin e ligjeve me interes të veçantë për gratë dhe fëmijët dhe Organizimi i dëgjimeve të ndryshme publike, tryezave të rumbullakta me ekspert të ndryshëm si dhe organizimin e konferencave rajonale të grave deputete nga vendet fqinje; Takime me gratë kryefamiljare në pjesë të ndryshme të Kosovës si dhe vizita në strehimore kolektive për gratë e keqtrajtuara; Takime të rregullta me shoqërinë civile dhe agjensionet qeveritare; Takime nëpër komuna me këshilltarë komunalë; Pjesëmarrja në debate mediale me qëllim të ngritjes së vetëdijes së publikut për çështje të ndryshme si arsimimi, shëndetësia, dalja e femrave në zgjedhje, rëndësia e kyçjes së femrës në ekonomi, etj. Duhet theksuar se ky grup joformal është nënshkrues i Memorandumit Ndërkombëtar për Luftë Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, dhe angazhohet fuqishëm në luftën kundër kancerit të gjirit.¹²⁹

¹²⁷ “Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës”, Neni 27.

¹²⁸ “Grupi Joformal i Deputeteve në Kuvendin e Kosovës”.

http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/WIG_info_broshura.pdf

¹²⁹ Ibid.

Prej 120 deputetëve, në Kuvendin e Kosovës gjinden 38 gra deputete.

Nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) janë gjithsej 10 gra deputete dhe këto janë: Blerta Deliu-Kodra; Evgjëni Thaci-Dragusha; Flora Brovina; Ganimete Musliu; Lirije Kajtazi; Luljeta Veselaj-Gutaj; Mexhide Mjaku-Topalli; Safete Hadërgjonaj; Sala Berisha-Shala dhe Xhevahire Izmaçu. Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) janë gjithsej tri deputete: Donika Kadaj-Bujupi; Teuta Haxhiu dhe Time Kadrijaj. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) janë zgjedhur këto gra: Besa Gaxherri; Doruntinë Maloku-Kastrati; Hykmete Bajrami; Mirjeta Kalludra; Teuta Rugova; Valentina Bunjaku-Rexhepi dhe Vjosa Osmani-Sadriu. Kurse nga Lëvizja Vetëvendosje numërohen gjashtë gra deputete: Albulena Haxhiu; Arbërie Nagavci; Drita Millaku; Fatmire Kollçaku; Fitore Pacolli-Dalipi dhe Saranda Bogujevci. Partia Nisma përfaqësohet nga Albulena Balaj-Halimaj dhe Emilija Redžepi. Ndërsa Partia Social-Demokrate nga tri deputete që janë Aida Dërguti, Besa Baftiu dhe Shqipe Pantina. Partia Alternativa përfaqësohet nga vetëm një deputete – Mimoza Kusari- Lila. Lista Serbe përmban katër gra deputete: Miljana Nikolić, Jasmina Zhivković, Jelena Bontić dhe Verica Čeranić. Koalicioni VAKAT (partia boshnjake) përfaqësohet nga Duda Balje, ndërsa Partia Demokratike Turke nga Müfëra Srbica-Şinik.¹³⁰

Nga analiza e të gjitha grave që aktualisht janë deputete, mund të përfundohet se kryesisht bëhet fjalë për gra të shkolluara dhe me merita profesionale. Kjo nënkupton që ato janë të kualifikuara për postet që kanë, por ka shumë gra të tjera që janë edhe më të shkolluara edhe me më tepër atributë profesionale, por që ndoshta nuk e kanë rrugën e hapur drejt politikës. Prandaj, me ose pa kuota nuk duhet të nënvlerësohet asnjëherë roli i gruas në politikë dhe në çdo sferë tjetër të jetës shoqërore.

Në Kuvendin e Kosovës janë pesëmbëdhjetë Komisione Parlamentare që ndahen në Komisione të Përhershme dhe Komisione Funksionale. Komisionet e Përhershme janë: Komisioni për Buxhet dhe Financa; Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim; Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Komisioni për Integritet Evropian. Ndërsa Komisionet Funksionale janë: Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike; Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi; Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal; Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor; Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media; Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës; Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione; Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.¹³¹ Poashtu, formohen edhe Komisionet hetimore sipas nevojës, dhe nën-komisionet ad-hoc.

¹³⁰ "Lista e deputetëve të Kuvendit të Kosovës". <http://www.kuvendikosoves.org/>

¹³¹ "Lista e Komisioneve të Kuvendit të Kosovës". <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,110>

Gjatë analizimit të përbërjeve të këtyre Komisioneve vërehet se gratë nuk janë në pjesëmarrje të barabartë me burrat. Sa u përket Komisioneve Parlamentare të Përhershme, dy prej tyre udhëhiqen nga gratë dhe dy nga burrat. Nga gratë udhëhiqen Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Komisioni për Integritet Evropian, ndërsa nga burrat Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim. Komisioni për Buxhet dhe Financa nga tetë anëtarë në përbërje ka vetëm një grua, ndërsa dy gra janë në kryesi si zëvendëskryetare. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim nga 12 anëtarë ka vetëm 3 gra në përbërje, pa asnjë grua në kryesi. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit nga tetë anëtarë ka vetëm dy gra në përbërje, përveq kryetares. Poashtu edhe Komisioni për Integritet Evropian ka të njëjtat shifra të përbërjes.¹³²

Ndërsa, gjatë analizimit të Komisioneve Funksionale vërehet poashtu pabarazi në raport me pjesëmarrjen e gruas. Prej dhjetë komisioneve, katër udhëhiqen nga gratë. Këto komisione janë: Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike; Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal; Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione. Gjitha komisionet kanë në përbërje nga tetë anëtarë, pa përfshirë kryesinë, dhe vetëm në një Komision prej 10 sosh, është numri më i madh i grave se i burrave (Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi) ku janë pesë gra dhe tre burra. Në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale është numri i barabartë mes gjinive, dhe në tetë Komisione tjera numri i grave anëtare është më i vogël se i burrave. Duhet theksuar se në tri Komisione të rëndësishme (administrim publik, financa dhe në bujqësi) është vetëm nga një grua anëtare.¹³³

III.3. Pjesëmarrja e gruas në Qeveri

Kur flitet për qeverinë, mund të thuhet se deri tani Kosova ende nuk ka pasur kryeministre femer. Mirëpo, nëpër kabinete qeveritare aty këtu janë rezervuar poste ministrash për gratë. Në qeverinë aktuale të Republikës së Kosovës janë tri gra ministre, në Ministrinë e Integritetit Evropian, në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Dhurata Hoxha është emëruar Ministre e Integritetit Evropian në shtator të vitit 2017, pozitë që është pasuar nga pozita që kishte si Ministre e Drejtësisë nga korriku i vitit 2016. Para se të emërohej Ministre, znj. Hoxha ishte Këshilltare Politike e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ku përgjegjësitë e saj mbulonin politikën e sigurisë dhe sundimit të ligjit. Në vitin 2008, ka përfunduar studimet master në Georgetown University në Washington DC, në

¹³² Ibid.

¹³³ Ibid.

departamentin e Studimeve të Sigurisë, me koncentrim në sigurinë ndërkombëtare. Ndërsa në 2004 ka përfunduar studimet e saj universitare në Graceland University, Ajova, SHBA, ku diplomoi në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Shkenca Politike. Mirëpo, një ministre si znj. Dhurata që mund të konsiderohet si ndër figurat më të kualifikuara të politikës shqipëtare, personifikon më së mirë sukseset dhe arritjet që një grua mund të ketë. Para posteve të tanishme politike ministria ka qenë shumë aktive edhe me punë dhe projekte tjera. Ka qenë këshilltare e Ministrit të Punëve të Brendshme që nga tetori 2008 – mars 2011, nga viti 1999 ka punuar edhe në Zyrën amerikane (tani Ambasada e SHBA) në Prishtinë në seksionin politik, ndërsa tani e disa vite është profesoreshë në disa kolegje të Prishtinës. Ka punuar edhe në Ambasadën Britanike si Menaxhere e projekteve, si dhe në OSBE dhe UNDP. Ajo është anëtare e Women in International Security (WIIS) me seli në Washington DC.¹³⁴

Në vitin 2013, kërkesa ligjore nga LBGJ (Ligji për Barazi Gjinore) ishte të ketë 40% përfaqësim të grave. Kjo ishte respektuar nga 10 Ministri : Ministria e Shëndetësisë (54.4%) ; Ministria e Integrimeve Evropiane (52.2%); Ministria e Diasporës (48.6%); Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (47.1%); Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (46.8%); Zyra e Kryeministrit (43.9%); Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (43.6%); Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (41.4%); Ministria e Administratës Publike (41.4%) dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik (40.8%). Ndërsa ishin edhe 10 ministri të tjera që nuk e kishin respektuar kërkesën në përqindje: Ministria e Punëve të Brendshme (39.7%); Ministria për Komunitete dhe Kthim (39.2%); Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (39.1%); Ministria e Drejtësisë (39%); Ministria e Financave (36.3%); Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (32.4%); Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (29.1%); Ministria e Punëve të Jashtme (27.4%); Ministria e Infrastrukturës (25.2%); Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës (24.8%). Situata në vitin 2014 sa i përket përfaqësimit të grave në Qeveri vazhdoi të ishte e njëjtë si në vitin paraprak me një ndryshim të vogël në përqindje në ministri të caktuara. Për shembull, Ministria e Drejtësisë rriti pjesëmarrjen në 40.4%, përderisa Ministria e Zhvillimit Ekonomik zvogëloi përqindjen e saj në 39.7%. 2015-ta shënon hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Barazi Gjinore, që kërkon si burrat edhe gratë të përfaqësohen në mënyrë të barabartë. Vetëm tri ministri përmbushën këtë kërkesë: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Integrimit Evropian dhe Ministria e Financave. Në vitin 2016, Zyra e Kryeministrit rriti përqindjen e saj të përfaqësimit të grave në 50.9%, duke qenë në pajtim me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore.¹³⁵

Sa i përket pozitave të larta drejtuese në qeveri, ato vazhdojnë të dominohen nga burrat. Gratë drejtuan vetëm 9.8% të numrit të përgjithshëm të këtyre pozitave në vitin 2013, përderisa në vitin 2014 kjo përqindje kishte rënë për 3.1%, pra vetëm 6.7% të pozitave të larta drejtuese drejtoheshin nga gratë. Në vitin 2015, përqindja e grave në pozita të larta drejtuese në Qeveri

¹³⁴ "Profile of the Minister", Ministry of European Integration. <http://mei-ks.net/en/profile-of-the-minister>

¹³⁵ "Pjesëmarrja e grave në vendimarrje në Kosovë", Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Prishtinë, 2016, fq.18.

ishite zvogëluar edhe më tej, duke e sjellë numrin në vetëm 5.2%, domethënë vetëm 3 pozita.¹³⁶ Duhet theksuar se Ligji për Barazi Gjinore vlen për të gjitha pozitat e punës dhe fakti që gratë po mbesin shumë larg pozitave drejtuese përbën papajtueshmëri me kërkesën e ligjit.

Për shembull nëse orientohemi në vitin 2013, “barazia gjinore” në pozitat drejtuese të ministrisë ka qenë kështu: Ministria e Punëve të Brendshme (31 vende pune për gratë / 153 vende pune gjithsej); Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (29 gra të punësuar / 112 pozita pune gjithsej); Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (16 gra të punësuar / 59 vende pune gjithsej); Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural (13 gra të punësuar / 54 vende pune gjithsej); Ministria e Administratës Publike (19 gra të punësuar / 51 pozita pune gjithsej); Ministria e Infrastrukturës (7 gra të punësuar / 47 pozita pune gjithsej); Ministria e Forcës dhe Sigurisë e Kosovës (12 gra të punësuar / 41 vende pune gjithsej); Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (13 gra të punësuar / 39 vende pune gjithsej); Ministria e Ekonomisë dhe Financave (12 gra të punësuar / 35 vende pune gjithsej); Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (6 gra të punësuar / 34 vende pune gjithsej); Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (10 gra të punësuar / 34 vende pune gjithsej); Ministria e Zhvillimit Ekonomik (8 gra të punësuar / 31 vende të punës gjithsej); Zyra e Kryeministrit (4 gra të punësuar / 28 vende të punës gjithsej); Ministria e Shëndetësisë (10 gra të punësuar / 27 vende pune gjithsej); Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (9 gra të punësuar / 25 vende pune gjithsej); Ministria e Punëve të Jashtme (6 gra të punësuar / 20 vende pune gjithsej); Ministria për Komunitete dhe Kthim (3 gra të punësuar / 15 vende pune gjithsej); Ministria e Integrimeve Evropiane (3 gra të punësuar / 12 vende pune gjithsej); Ministria e Diasporës (4 gra të punësuar / 9 vende pune gjithsej); Ministria e Drejtësisë (1 grua e punësuar / 1 pozitë gjithsej).¹³⁷

Përkatësisht në një përmbledhje totale, del që 216 pozita drejtuese për gra nga 827 pozita drejtuese në total (26.1%)! Ndërsa në vitin 2014 del që 228 pozita për gra nga 859 pozita në total (26.5%); kurse në vitin 2015 numrat rezultojnë 301 nga 1155 (26.1%).¹³⁸

Me analizimin e pozitave të zëvendësministrave vërehet poashtu mosrespektimi i Ligjit për Barazi Gjinore. Këto pozita janë shumë të dominuara nga gjinia mashkullore. Për shembull, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë janë gjashtë zv.ministra meshkuj; në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit janë dy femra dhe dy meshkuj; në Ministrinë e Shëndetësisë janë katër meshkuj; në Ministrinë e Punëve të Jashtme nga katër pozita, janë tre meshkuj dhe një femër; në Ministrinë e Punëve të Brendshme janë katër meshkuj zv.ministra; në Ministrinë e Integrimeve Evropiane është një zv.ministër mashkull; në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik janë pesë zv.ministra dhe asnjë zv.ministre; dhe në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë tre meshkuj dhe një femër zv.ministre.¹³⁹ Pra, është e dukshme pabarazia gjinore që ekziston edhe në këtë pozitë pune.

¹³⁶ Ibid, fq.20.

¹³⁷ Ibid, fq.22.

¹³⁸ Ibid.

¹³⁹ Ministrinë përkatëse të Republikës së Kosovës.

Përkundër faktit se gratë më vështirë depërtojnë drejt ministrive, është e vërtetuar se ato që ia arrijnë janë tejet të përgatitura dhe të kualifikuara. Jo domosdoshmërisht në postin e ministres, por edhe në poste tjera drejtuese, gratë që i pranojnë postet e tilla janë të përkushtuara në punët që bëjnë dhe dalin të suksesshme në përmbushjen e detyrimeve dhe obligimeve.

Në Kosovë kemi pasur gra të suksesshme në postin e ministres, gra që kanë pasur merita dhetribute në karrierë dhe që ia kanë dalë mbanë edhe me postin që u është besuar. Për shembull, *Vlora Çitaku* ka qenë Ministre e Integritetit Evropian nga viti 2010 deri 2014, ushtruese e detyrës së Ministres së Jashtme (2009-2010) ndërsa nga 2014 deri me 2015 ka qenë Konsulle e përgjithshme e Republikës së Kosovës në Nju Jork. Aktualisht është Ambasadore e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pastaj, *Edita Tahiri* ka qenë Ministre për Dialog e Republikës së Kosovës nga viti 2014 deri me 2017 dhe Zëvendës Kryeministre nga viti 2011 deri me 2014. Tahiri është diplomuar në Universitetin e Harvardit dhe ka diplomuar për Administratë Publike nga Shkolla John F. Kennedy në vitin 2002. Ajo gjithashtu është diplomuar në Programin Edward S. Mason për Politikë Publike dhe Menaxhimin. *Hikmete Bajrami* ka qenë ministre e Tregtisë dhe Industrisë nga 2014 deri me 2017 ndërsa momentalisht është deputete në Kuvendin e Kosovës. Ka përfunduar gradën Master në Staffordshire University në Britaninë e Madhe, dhe ka doktoruar në Univerzitetin e Prishtinës. *Mimoza Kusari-Lila* është përmendur edhe më herët brenda punimit pasi përfaqëson një grua që nuk është dorëzuar derisa i ka arritur qëllimet e saja në karrierë, përfaqëson një grua të fortë dhe të patrembur në rrugën drejt synimeve. Prej vitit 2011 deri me 2013 ka shërbyer si Ministre e Tregtisë dhe Industrisë në Republikën e Kosovës, prej 2014 deri me 2017 kryetare e Komunitetit të Gjakovës, ka themeluar partinë “Alternativa” dhe aktualisht është deputete në Kuvendin e Kosovës. *Albena Reshitaj* ishte emëruar ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vitin 2017, e diplomuar në Stomatologji dhe doktorante e Shkencave Mjekësore.

Gratë kanë dëshmuar se mund t’ia dalin edhe në politikë por edhe në drejtimet e tyre profesionale të zgjedhura, madje t’i bëjnë të dyja njëkohësisht. Gratë janë të suksesshme në politikë madje edhe në poste tjera drejtuese sepse duan të kryejnë punë dhe të kenë sukses, por nuk duan të kënaqin egon e tyre me postet e larta, madje as nuk kanë tendencë xhelozie dhe lakmie. Gratë duhet të kenë shumë më tepër poste drejtuese për të mirën e këtij populli dhe për të mirën e këtij shteti.

III.4. Pjesëmarrja e gruas në Presidencë

Dihet që Presidenca paraqet një institucion tepër të rëndësishëm për një shtet, prandaj duhet pasur kujdes se kush vendoset në krye dhe në përbërje të saj. Ka rëndësi të madhe që edhe nivelet drejtuese në Presidencë, këshilltarët, dhe nënpunësit civil të zgjidhen duke u respektuar barazia gjinore.

Sipas të dhënave nga Presidenca për këshilltarët politik të Presidentit, duket se barazia gjinore është respektuar gjatë viteve 2013-2015 (8 këshilltarë gjithsej - 4 burra dhe 4 gra). Në anën tjetër, në vitin 2016 ka qenë një grua më pak si këshilltare politike e Presidentit. Përkundër respektimit të barazisë gjinore në rastin e këshilltarëve politik (me përjashtim të vitit 2016), për përfaqësimin gjinor të nëpunësve civil në Presidencë del se ajo në vazhdimësi nuk është duke respektuar barazinë gjinore. Përfaqësimi i burrave në Presidencë është 62.8% kurse ai i grave 37.2%, edhe në pozita drejtuese në Presidencë favorizohen burrat. Nga 32 pozita drejtuese gjithsej (në nivel të lartë drejtues dhe në nivel drejtues), 18 pozita udhëhiqeshin nga burrat dhe 14 nga gratë.¹⁴⁰ Ndërkaq Presidenti aktual i Kosovës nga 2016-ta, në stafin e tij, ka dhjetë këshilltarë prej të cilëve të gjithë janë burra, pra nuk e ka respektuar fare ligjin për Barazi Gjinore në këtë pjesë. Mirëpo, sa i përket ekipit administrativ ka emëruar tri gra si zyrtare të larta administrative.¹⁴¹

Sa i përket postit të Presidentit, detyra e parë si President i ka takuar Dr.Fatmir Sejdiut nga viti 2006 deri me 2010, pason Dr.Jakup Krasniqi si ushtrues detyre nga 2010 deri me 2011, përkatësisht për më pak se një vit ushtron detyrën e Presidentit, pastaj Behxhet Pacolli për një kohë shumë të shkurtër (22 shkurt – 30 Mars 2011), dhe nga viti 2011 deri me 2016 Presidente e Republikës së Kosovës zgjidhet znj.Atifete Jahjaga, e cila është gruaja e parë në këtë post, dhe pastaj pason Hashim Thaçi (Presidenti aktual).

Presidentja Jahjaga ka lënë pas vetes histori sepse jo vetëm është e para grua Presidente në Kosovë por edhe në Ballkan, njëkohësisht edhe liderja më e re femër në botë në postin e Presidentes. Ajo ka shërbyer si zëvendës drejtoreshë e Policisë së Kosovës, duke mbajtur gradën e gjeneral majorit, grada më e lartë në mesin e grave në Evropën Juglindore. Arsimimi i saj univerzitar fillon në Kosovë në Univerzitetin e Prishtinës për juridik, por pastaj vazhdon programe pasuniverzitare në Mbretërinë e Bashkuar e pastaj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Virginia). Mirëpo, avancimi i saj profesional ka pasuar edhe në institutin “George Marshall” në Gjermani, Akademinë e FBI-së në SHBA dhe në Ministrinë e Drejtësisë të po të njejtës. Ka qenë zyrtare e Policisë së Kosovës që prej themelimit nga viti 2000. Në vitin 2011 ajo ishte shpallur si kandidate konsensuale për Presidente nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, sigurisht e përkrahur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkatësisht Ambasadori Christopher Dell. Jahjaga ishte në kandidim me politikanen Suzan Novobërdali, kundrejt të cilës fitoi në votim të parë, u zgjodh Presidente dhe u tejkalua ngërçi politik që mbizotëronte. 35-vjeçarja siguroi pozitën me 80 vota në parlamentin 120-anëtarësh, me vetëm 100 anëtarë që votuan.¹⁴²

¹⁴⁰“Pjesëmarrja e grave në vendimarrje në Kosovë”, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Prishtinë, 2016, fq.24,25.

¹⁴¹ “Ekipi i Presidentit”, Presidenca e Republikës së Kosovës.

<https://www.president-ksgov.net/sq/ekipi-i-presidentit>

¹⁴² “Kosovo elects female police chief as new president”, Deutsche Welle.

<https://www.dw.com/en/kosovo-elects-female-police-chief-as-new-president/a-14974933>

Lirisht mund të thuhet se Presidentja Jahjaga ka qenë dhe mbetet shembull për politikanët e tjerë jo vetëm në Kosovë por edhe më gjërë. Me qëndrimin, përgatitjen dhe bagazhin e saj ka arritur që në gjitha takimet, mbledhjet dhe tubimet ku ka marrë pjesë të lërë përshtypje të mirë. Poashtu, ish-Presidentja ka bërë shumë edhe për fuqizimin e rolit të gruas në Kosovë.

Në vitin 2012, Presidentja Jahjaga organizoi Samitin Ndërkombëtar të Gruas ku morën pjesë më se 200 gra lidere nga Kosova, rajoni dhe bota. Samiti ishte një mundësi e mirë për gratë e rajonit për t'i kaluar barrierat etnike dhe të bashkohen për të promovuar një platformë për fuqizimin e tyre në të gjithë Ballkanin. Gjithashtu ka organizuar edhe nisma për mbështetjen sociale dhe shëndetësore të viktimave të dhunës seksuale në Kosovë gjatë luftës së fundit, njëkohësisht edhe integrimin e tyre në shoqëri.¹⁴³

III.5. Pjesëmarrja e gruas në qeverisje lokale

Përderisa u theksua dhe u mbitheksua rëndësia e madhe e përfshirjes së gruas në gjitha qelizat e politikës, mund të thuhet se pjesëmarrja e gruas me patjetër duhet të jetë e dukshme edhe në qeverisjen lokale. Përkundër kësaj, shkalla e pjesëmarrjes së gruas në qeverisje lokale lë shumë për të dëshiruar.

Për shembull, nëse ilustrime me disa komuna ku janë bërë hulumtime për këtë pjesë mund të vërtetojmë se gratë nuk janë të përfaqësuara në shkallën e duhur. Praktikën e qeverisjes së kaluar në Komunën e Prizrenit (2013-2017) nuk kanë lënë një pasqyrë të mirë në përfaqësimin e grave në dikasteret e saj. Janë emëruar kështu vetëm dy (2) gra në udhëheqje nga gjithsej njëmbëdhjetë (11) drejtori, drejtori të cilat edhe mund të mendohet që kanë qenë më shumë stereotipike se sa meritore. E njëjta ndodh edhe në përfaqësimin e grave në komitete të ndryshme, ku shihet të ketë fare pak përfaqësim të grave dhe me këtë fakt kuptohet se ato sa më pak që janë të përfaqësuara në dikastere të rëndësishme, aq më pak e kanë mundësi t'i adresojnë dhe të marrin zgjidhje për problemet me të cilat ballafaqohen në lagjen apo komunën e tyre.¹⁴⁴

Poashtu, Instituti Demokratik i Kosovës në hulumtimin e fundit të tyre këtë vit mbi përfshirjen e grave në qeverisjen lokale theksuan se përfshirja e gruas dhe rinisë paraqet një problematikë në vazhdimësi, por që janë duke punuar shumë që këtë çështje ta adresojnë. Nga 14 drejtori në qytetin e Pejës, janë të përfshira 3 gra. Në shkollë janë 10 drejtoresha nga 36 sosh. Në dikastere të ndryshme të administratës janë të emëruara 12 gra si shefe, por dihet se duhet ende punë sepse janë shumë larg respektimit të ligjit për Barazi Gjinore (50:50).¹⁴⁵

¹⁴³ "Rape as a Weapon of War: A Conversation with Former Kosovo President Atifete Jahjaga", Center for Strategic and International Studies, 2019.

<https://www.csis.org/events/rape-weapon-war-conversation-former-kosovo-president-atifete-jahjaga/>

¹⁴⁴ "Qeverisje Lokale që garanton barazi gjinore", Kosova Democratic Institute, Prizren, 2017, fq.6.

¹⁴⁵ "Komuna e Pejës: Përfshirja e rinisë dhe grave për qeverisje më të mirë lokale", Kosova Democratic Institute, Prishtinë, 2019.

<https://d4d-ks.org/aktivitetet/komuna-e-pejes-perfshirja-e-rinise-dhe-grave-per-qeverisje-te-mire-lokale>

Duket qartë që barazia gjinore në komunat e Kosovës nuk respektohet. Në vitin 2015, vetëm 28% të të punësuarëve në shërbimin civil ishin gra, përderisa kjo situatë ka qenë edhe më e rëndë në vitet 2013-2014 me vetëm një të katërtën (25%) e të punësuarëve që i takojnë kësaj kategorie. Pozitat drejtuese në Komuna, do të thotë drejtorët e drejtorateve komunale, vazhdojnë të udhëhiqen në masë të madhe nga burrat. Vetëm 4.4% e pozitave në vitin 2013-2014 drejtoheshin nga gratë, përderisa kjo përqindje është rritur në 10.1% për vitin 2015. Në vitin 2015, komunat e Kosovës kishin vetëm 32 gra në pozita drejtuese nga 318 pozita gjithsej, ose 10.1%. 14 nga komunat e Kosovës nuk kishin asnjë grua në pozita drejtuese. Kjo situatë është pak më e mirë krahasuar me atë në 2013-2014 kur 22 komuna nuk kishin asnjë grua në pozita të tilla.¹⁴⁶

Nëse përfshijmë për ilustrim shumicën e komunave në Kosovë, struktura gjinore e të punësuarëve në pozita udhëheqëse në administratën komunale në vitin 2014 ka qenë në këto shifra: në komunën e Deçanit nga 31 pozita udhëheqëse në total, 28 pozita ju kanë takuar burrave dhe vetëm 3 pozita grave përkatësisht 10%; në Ferizaj nga 46 pozita gjithsej, 35 pozita për burra dhe 11 pozita për gra ose 24%; në Gjakovë nga 49 pozita, 46 u kanë takuar meshkujve dhe 3 pozita grave përkatësisht 6%; në Gjilan gjithsej 36 pozita, prej të cilave 35 pozita u kanë takuar burrave dhe 1 pozitë dedikuar grave, përkatësisht 3%; kurse në kryeqytet nga gjithsej 54 pozita, 38 pozita janë zënë nga burra dhe 16 nga gratë përkatësisht 28%; Drenasi prej 31 pozitave gjithsej, në 22 pozita ka emëruar meshkuj ndërsa në 9 pozita gra, pra 32%; Prizreni prej 40 pozitave që sipas ligjit për Barazi Gjinore ishte dashur t'i emërojë 20 pozita për burra dhe 20 për gra, ka emëruar 32 burra dhe 8 gra përkatësisht 20%, kurse Peja nga 50 pozita gjithsej i ka emëruar 34 burra dhe 16 gra, përkatësisht 32%. Ndërsa në po të njejtin vit, numri i përgjithshëm i të punësuarëve gra figuron kështu: në Deçan 20%; në Ferizaj 28%; në Fushë Kosovë 36%; në Gjakovë 26%; Gjilan 24%; Pejë 32%; Podujevë 20%; Prishtinë 35%; Prizren 25%; Skenderaj 17%; Kamenicë 22% etj.¹⁴⁷

Nëse analizojmë edhe pjesëmarrjen e gruas në Asamble kuptojmë se përqindja femërore nuk kap as gjysmen e ulëseve totale në Asamble. Për shembull në Asamblenë e Prishtinës nga gjithsej 49 ulëse vetëm 18 prej tyre janë të zëna nga gratë; në Asamblenë e qytetit të Gjakovës nga 35 ulëse, 15 u takojnë grave; në Ferizaj nga totali prej 41 ulëse, vetëm 14 u takojnë grave; në Gjilan nga 35 ulëse për gratë janë vetëm 13 ulëse; në Asamblenë e Prizrenit nga 39 ulëse të zëna nga gratë janë vetëm 16 sosh; Peja nga 36 vende në Asamble, 12 i ka për gratë; në Drenas nga 31 ulëse, 10 janë të zëna nga gratë; në Podujevë nga 34 ulëse, 12 janë të grave; në Kaçanik nga 27 ulëse në Asamble, gratë janë në 11 prej tyre; në Deçan prej 27 ulëseve janë të zëna nga gratë vetëm 10 ndërsa në Skenderaj prej 31 ulëseve të zëna nga gratë janë 9 sosh.¹⁴⁸

¹⁴⁶ "Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në Kosovë", Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj), Prishtinë, 2016, fq.25,29.

¹⁴⁷ "Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale, dhe në partitë politike në Kosovë", Agjencia për Barazi Gjinore, Prishtinë, 2014, fq.25,26.

¹⁴⁸ Të dhënat janë marrë nga faqet zyrtare të secilës komunë të përmendur.

Deri sot në Kosovë vetëm një grua ka arritur të mbajë postin e të parës së komunës, pra vetëm një grua ka arritur të zgjidhet kryetare, dhe kjo ishte Mimoza Kusari-Lila. Ajo kishte kandiduar në vitin 2009, dhe përkundër humbjes ndaj kundër-kandidatit gjeti forcën dhe motivimin të kandidojë prapë në 2013 dhe nga janari 2014 të jetë në postin që e kishte synuar. Definitivisht për të arritur objektivat e synuara në karrierë sidomos në atë politike në Kosovë, gratë duhet pasur kurajon dhe guximin në rend të parë, sepse vetë sistemi është i strukturuar i tillë t'i dekurajojë, "t'i nxjerrë jashtë lojë" shumë shpejtë dhe tu ulë vetëbesimin. Prandaj, znj.Kusari-Lila ia doli sepse edhe pa pëlqimin dhe mbështetjen e të tjerëve për kandidimin e saj, ajo besoi në vetvete dhe i kishte vizionet e qarta se çfarë donte dhe ku e shihte veten. Prandaj, arritjet dhe fitorja nuk vijnë pa mund dhe sakrificë për asnjë person, por për gratë në Kosovë vërtetë munda dhe sakrifica janë goxha të mëdha, duhet vetëbesim dhe vetëiniciativë e lartë për të kaluar sfidat profesionale dhe personale që vetëm iu shtohen në rrugëtimin politik.

Përfundimi dhe Rekomandimet

Pjesëmarrja e gruas në politikë reflektohet pozitivisht jo vetëm në sferen politike por edhe në atë sociale, ekonomike dhe jetësore në përgjithësi. Meqë demokracia nënkupton përfshirjen mbarëqytetare, atëherë involvimi i gruas në sferat politike forcon demokracinë dhe barazinë gjinore brenda një shteti.

Pjesëmarrja në politikë është e drejtë e secilit njeri madhor, mirëpo në rastin e grave ndodhin diskriminime të shumta, pengesa në rrugën e tyre politike, u mbyllen dyer të shumta dhe dominanca mashkullore në politike e bën pothuajse të pamundur depërtimin femëror.

Prandaj, vendet e Ballkanit që njihen si vende në zhvillim dhe janë në procese të përvetësimit të politikave të ndryshme të shtetndërtimit, ende nuk e kanë vendosur fokusin e tyre kryesor në rritjen e pjesëmarrjes së gruas në politikë. Prandaj, edhe mënyra se si konceptohet ende figura e gruas dhe detyrat familjare që duhet të kryejë ajo, ia privojnë deri diku karrierën dhe jetën publike.

Duke marrë fokus të veçantë Kosovën, gratë ende diskriminohen dhe nuk u jepen pozitat që meritojnë, ende hasin në peripeci të shumta deri në një involvim sipërfaqësor politik, sepse

stereotipet e vazhdueshme, barrierat psikologjike dhe trysnitë e ndryshme vështirë ua mundësojnë pozitat e larta për të cilat ato luftojnë. Megjithatë, politika e sotme me dhunë, banalitet, skena turpi dhe pa vlera është mjedis i ashpër për femrat dhe natyrën e tyre. Por, mund të them se një involvim më i madh femëror do neutralizonte situatën dhe politika do ishte më tepër e bazuar në një diplomaci të butë dhe negociuese sesa në një shpërthim agresiv dhe tmerrues siç ndodh të shohim nëpër seanca parlamentare, debate publike apo protesta që fillojnë si paqësore dhe pasaj eskalojnë.

Kosova ka përparuar me sistemin e aplikuar të kuotave, mirëpo ajo duhet të mbetet vetëm një nismëtare drejt një progresi të madh në involvimin femëror në politikë. Politika në Kosovë duket që ec drejt një rruge pa krye, dhe karakteristikat e udhëheqjes femërore them se mund ta drejtonin nga rruga e duhur.

Në Kosovë në vend se të ndërtohen mure për të mbajtur larg gratë nga politika, më mirë të ndërtohen ura ku lidhshipi femëror dhe mashkullor mund të bashkëpunojnë drejt krijimit të perspektivave të reja për popullatën dhe ndërtimin e një shteti ndryshe nga çka është katandisur sot.

Duhet që të forcohet korniza ligjore për mbrojtjen dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikën kosovare. Të mbikqyret zbatimi i ligjeve, të jepen dënime dhe sanksione për këdo që nuk respekton ligjet, partitë politike të përdorin mekanizma për të mbështetur gratë dhe involvimin e tyre politik. Poashtu, edhe organizatat civile duhet të aktivizohen dhe të monitorojnë zbatimin e kuotave gjinore, të hulumtojnë mbi efektet që kanë dhe njëkohësisht të propozojnë forma për inkuadrimin e mëtutjeshëm të gruas kosovare drejt politikës.

Duhet të rritet mbështetja për gratë kandidate dhe ato të marrin hapësirën që u takon në postet partiake, në mbledhje, në fushata, në media dhe debate, dhe poashtu të marrin pjesë në ndarjen e burimeve financiare. Vetë partitë politike duhet të balancojnë lidhshipin gjinor në strukturat e brendshme por edhe në paraqitjet e jashtme. Edhe pjesëmarrja në trajnime dhe aftësi profesionale duhet të jetë e hapur ndaj grave dhe t'u mundësohen avancimet në karrierë.

Duhet që një herë e mirë të kuptohet fuqia e gruas si në politikë ashtu edhe në çdo sferë të jetës. Duhet ditur se gruaja përbën një fuqi votuese dhe duhet të zhvillohen platforma dhe agjenda për avancimin e tyre. Përbën domosdoshmëri edhe angazhimi me meshkujt sidomos me gjeneratat e reja, duke i mësuar të bëjnë sfidimin e normave patriarkale dhe stereotipeve gjinore për pjesëmarrjen e grave në politikë.

Bibliografia

- “Equality between women and men”, Council of Europe.
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168064f51b>
- “Grupi Joformal i Deputeteve në Kuvendin e Kosovës”.
http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/WIG_info_broshura.pdf
- “Ligji Nr. 05/L -020 për Barazi gjinore”, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.16, 26 Qershor, Prishtinë, 2015.
- “Lista e deputetëve të Kuvendit të Kosovës”. <http://www.kuvendikosoves.org/>

- Agolli, Ilirian, “Studiuesit: Pjesëmarrja e grave në vendim-marrje, formale”, Mars, 2013, Zëri i Amerikës. <https://www.zeriamerikes.com/a/women-albania/1617890.html>
- Agjencia për Barazi Gjinore, “Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale dhe në partitë politike në Kosovë”, Prishtinë, 2014.
- Ahma, Liridona, “Kusari-Lila nuk e sheh të pamundshme udhëheqjen e politikës nga gratë”, Qershor, 2019, Jahjaga Foundation, Prishtinë.
<https://jahjagafoundation.org/index.php/2019/06/13/kusari-lila-nuk-e-sheh-si-te-pamundshme-udheheqjen-e-politikes-nga-grate/>
- Ballington, Julia & Binda, Francesca, “The Implementation of Quotas: European Experiences”, Idea, Stockholm, 2005.
- Ballington, Julie & Binda, Franceska, “The Implementation of Quotas: European Experiences”, Idea, Stockholm, 2005.
- Banaszak, Lee Ann, “Why movements succeed or fail: opportunity, culture, and the struggle for woman suffrage”, Princeton University Press, 1996.
- Beach, Cecilia, “Staging Politics and Gender: French Women's Drama, 1880-1923”, Palgrave Macmillan, 2005.
- Beauvoir, Simone, “The Second Sex”, Jonathan Cape Publishing, Londër, 1953.
- Beckman, Peter & D’Amico, Francine, “Women, Gender and World Politics”, Bergin & Carvey, Londër, 1994.
- Bratton & Ray, “Descriptive Representation, Policy Outcomes, and Municipal Day-Care Coverage in Norway”, American Journal of Political Science, 2002.
- Burrell, Barbara, “Women and Political Participation”, 2004.
- Cambridge Business English Dictionary, Cambridge University Press, 2019.
<https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/gender-equality>
- Center for Strategic and International Studies, “Rape as a Weapon of War: A Conversation with Former Kosovo President Atifete Jahjaga”, 2019. <https://www.csis.org/events/rape-weapon-war-conversation-former-kosovo-president-atifete-jahjaga/>
- CESInstitute, “Women and Politics: Overcoming Barriers to Participating in leadership”, Canada, 2017.
- Davis, Angela, “Women, Culture & Politics”, Random House, New York, 1990.

- Demjaha, Agon and Agai-Demjaha, Teuta, “Participation of Women in Local Governance in the Republic of Macedonia”, in Ylber Sela eds. Decentralization Process in the Republic of Macedonia: Main issues, trends and developments in the future, Institute for Political and International Studies, 2013.
- Deutsche Welle, “Kosovo elects female police chief as new president”.
<https://www.dw.com/en/kosovo-elects-female-police-chief-as-new-president/a-14974933>
- Driedger, Myrna, “Challenges for women in Politics”, Canadian Parliament review, 2013.
- Gender Quality in Ireland, “UN Convention on the Elimination of all forms of Discrimination against Women (CEDAW)”.
<http://www.genderequality.ie/en/GE/Pages/CEDAW>
- Gender quality in Ireland, “What is Gender Equality?”.
<http://www.genderequality.ie/en/GE/Pages/WhatisGE>
- Goldstein, Joshua, “Marëdhëniet Ndërkombëtare”, Shtëpia botuese Drita, Prishtinë, 2001.
- Halpern, Diane & Cheung, Fanny, “Women at the Top: Powerful Leaders Tell Us How to Combine Work and Family”, Willey-Blackwell Publications, Oxford, 2008.
- Htun, Mala & Jones, Mark, "Engendering the Right to Participate in Decision-making: Electoral Quotas and Women's Leadership in Latin America", Palgrave, Londër.
- Instituti i Studimeve Politike, “Standardet e përfaqësimit në partitë politike”, Tiranë, 2017.
- Instituti Kombëtar Demokratik, “Kosovë: Tejkallimi i pengesave për pjesëmarrjen e grave në politikë”, Prishtinë, 2015.
- Jansen, Sharon, “Debating women, politics and power in early modern Europe”, Palgrave Macmillan, New York, 2008.
- Kalaja, Besa, “Rrëfimi i Luljeta Pula Beqirit mbi rrugëtimin e saj të gjatë në politikë”, Qershor, 2019, Jahjaga Foundation, Prishtinë.
<http://jahjagafoundation.org/index.php/2019/06/18/rrrefimi-i-luljeta-pula-beqirit-mbi-rrugetimin-e-saj-te-gjate-ne-politike/>
- Keçmezi-Basha, Sabile, “Feja Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarë” (simpozium ndërkombëtar), Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë, 1995.
- Kosova Democratic Institute, “Komuna e Pejës: Përfshirja e rinisë dhe grave për qeverisje më të mirë lokale”, 2019. <https://d4d-ks.org/aktivitetet/komuna-e-pejes-perfshirja-e-rinise-dhe-grave-per-qeverisje-te-mire-lokale>

- Kosova Democratic Institute, “Platformë- Qeverisje Lokale që garanton barazi gjinore”, Prishtinë, 2017.
- Lantara NF, “The Roles of Woman as Leader and Housewife”, J Def Manag 5, 2015.
- Leijenaar, Monique, “Political Empowerment of women: The Netherlands and Other Countries”, Martinus Nijhoff Publishers, Boston, 2004.
- Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
- Lovenduski, Joni, “Women and European Politics: Contemporary Feminism and Public Policy”, 1986.
- Matland, Richard & Montgomery, Kathleen, “Women’s access to political power in post-communist Europe”, Oxford University Press, 2003.
- Matland, Richard & Studlar, Donley, “The Contagion of Women Candidates in Single-Member District and Proportional Representation Electoral Systems: Canada and Norway”, Journal of Politics, Vol.58, 1996.
- Mill, John Stuart, “The Subjection of Women”, Longmans, Londër, 1869.
- Nagendra, Shilaja, “Women’s Role in Modern World”, ABD Publishers, Jaipur, 2008.
- OECD, “Gender and Sustainable Development - Maximising the economic, social and environmental role of women”, 2008. <https://www.oecd.org/social/40881538.pdf>
- Osho, “Femra”, Shtëpia botuese ‘Fan Noli’, Tiranë, 2014.
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore, “Pjesëmarrja e grave në vendimarrje në Kosovë”, Prishtinë, 2016.
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore, “Si votojnë gratë në Kosovë”, Prishtinë, 2014.
- Randall, Vicky, “Women and Politics: An International Perspective”, Macmillan Education UK, 1987.
- Savigny, Heather & Warner, Helen, “The Politics of Being a Woman: Feminism, Media and 21st Century Popular Culture”, Palgrave Macmillan UKCity, 2015.
- Semini-Tutulani, Mariana, “Konfliktet gjyqësore të marrëdhënieve të punës parë nën perspektivën e barazisë gjinore”, Shkolla e Magjistraturës & UNDP, Tiranë, 2013.
- Sinha, Niroj, “Empowerment of women through political participation”, Kalpaz Publications, 2013.

- Sperling, Liz, “Women, Political Philosophy and Politics”, Edinburgh University Press, 2002.
- Tripp, Aili & Kang, Alice, “The global impact of quotas on the fast track to increased female legislative representation”, Comparative Political Studies, no.3, 2008.
- Trotsky, Leon, “Women and Family”, Pathfinder Press, SHBA, 1970.
- UNDP, “Fuqizimi i grave për parti politike më të forta”, Prishtinë, Shkurt, 2012.
- UNDP, “Udhëheqja dhe pjesëmarrja e grave në politikë”, Prishtinë, 2014.
- United Nations Charter ,“Chapter I”. <https://www.un.org/en/sections/un-charter/chapter-i/index.html>
- United Nations Charter,“Preamble. <https://www.un.org/en/sections/un-charter/preamble/>
- United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women, “Concepts and definitions”. <https://www.un.org/womenwatch/osagi/conceptsanddefinitions.htm>
- United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women, “Overview of the Convention”. <https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/index.html>
- United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women, “Short History of CEDAW Convention”. <https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/history.htm>
- UNMIK, Raport përmbledhës: “Dita globale e OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë me fokus në pjesëmarrjen e grave të Kosovës në politikë”, Prishtinë, 2018.
- USAID, “Përfaqësimi i grave në bordet e ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura”, Prishtinë, Qershor, 2017.